

LIGJI PËR SHOQËRITË, KAPITULLI 113
SHOQËRI AKSIONERE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

AKTI I THEMELIMI
I SHOQËRISË
DALEWEST LIMITED

1. Emri i shoqërisë është:
DALEWEST LIMITED


2. Selia e shoqërisë ndodhet në Qipro.

3. Shoqëria ka për objekt:

- (1) të kryejë vetëm apo së bashku me të tjerët, kudo në botë, aktivitetin e një shoqërie investuese (duke përfshirë edhe cilësinë e një shoqërie besimi) dhe të fitojë me nënshkrim, kontratë, blerje, shkëmbim apo të ngjashme, në emër të shoqërisë apo të çdo të emëruari, dhe të posedojë, shfrytëzojë, ngarkojë, shkëmbejë, mbajë, shesë apo të tjetërsojë në çdo mënyrë tjetër, me cdo kusht kontraktor, aksione, letra me vlerë, detyrime, të dhëna apo të lëshuara dhe të garantuara nga çfarëdo autoritet qeveritar, person fizik apo juridik, ortakëri, organ publik apo autoritet suprem, organ i qeverisjes vendore, dhe pavarësisht nëse janë apo nuk janë paguar plotësisht dhe me kushte që mund të konsiderohen të përshtatshme, dhe të fitojë, posedojë, shfrytëzojë, shesë apo të tjetërsojë në çdo mënyrë tjetër, me kushte që mund të konsiderohen të përshtatshme, të gjithë apo pjesë të aktivitetit, patentave, shpikjeve, konçesioneve, skicimeve, markave, procese sekrete të së drejtës së autorit, liçenca, shpikje, të drejta dhe privilegje që ngarkohen me *royalty*, të dhëna apo jo mbi bazë ekskluziviteti.
- (2) të kryejë vetëm apo së bashku me të tjerët, kudo në botë, aktivitete që lidhen me pasuritë e paluajtshme në përgjithësi, zhvillimin, blerjen, shitjen, leasing apo nën-leasing dhe financimin, dhe të fitojë me dhurim, të shkëmbejë apo të zotërojë ankande dhe të shfrytëzojë çdo pasuri të paluajtshme si dhe çdo aktivitet që lidhet me ndërtimin, mirëmbajtjen, dekorimin, operimin, menaxhimin dhe administrimin e çdo pasuri të paluajtshme që i përket shoqërisë apo të tretëve, shtëpive, apartamenteve, zyrave, blloqeve, hoteleve, ndërtimeve turistike, dyqaneve, panairove, rezervuareve të ujit, rrugëve, ndërtesave apo ndërtimeve të tjera të çdo lloj përshkrimi, dhe t'i tregëtojë, shesë, apo marrë me qira, blejë, japë me qira, të vejë hipotekë, të japë liçenca apo në ndonjë mënyrë t'i ofrojë tërësisht apo pjesërisht ato dhe të kryejë të gjitha llojet e punimeve tokësore, ndërtimin dhe kontraktorin ndërtues, mekanikun, arkitektin, dhe të gjitha tipet e punimeve ndërtuese.
- (3) të kryejë vetëm apo së bashku me të tjerët, kudo në botë (dhe në "ndonjë zonë të lirë", zonë kufitare apo gjetiu), aktivitetin e prodhuesit, profesorit, tregtarit, magazinuesit, paketuesit, shitësit me shumicë, shitësit me pakicë, importuesit, eksportuesit, furnitorit, distributorit, dorëzuesit, blerësit, shitësit, rishitësit të çdo materiali të tregtueshëm, si dhe aktivitetin e tregtarit në përgjithësi, transportuesit me mjete transporti, agjentit të udhëtimit apo të sigurimit, agjentit me komision, duke dërguar agjentë, agjentë pasurorë dhe agjentë në përgjithësi dhe të kryejë

vetëm apo së bashku me të tjerët në botë aktivitetin e menaxherit dhe konsulentit të përgjithshëm dhe të specializuar.


- (4) të angazhojë, punësojë dhe trajnojë stafe dhe punonjës profesionistë, klerikë, teknikë dhe punonjës të tjerë si dhe shërbimet e tyre apo të ndonjërit prej tyre, në çdo mënyrë, dhe të fitojë posedimin e fabrikave apo të shtjerë në dorë të gjitha pronat, e çdo tipi, (duke përfshirë të gjitha të drejtat në lidhje me këto prona) dhe të alokojë dhe t'a verë në dispozicion këtë personel apo këto shërbime apo të përdorë pronat në dispozicion duke i dhënë me qira, duke i blerë, shitur, shkëmbyer me ato që kanë nevojë apo që i kërkojnë ato si dhe t'i përdorin ato për qëllimet e shoqërisë; të sigurojë nga të tjerët të gjitha shërbimet dhe t'i ofrojë atyre çdo aktivitet që kanë nevojë dhe që lidhet me aktivitetin e ofruar prej tyre.
- (5) të kryejë çdo aktivitet tjetër, i cili sipas gjykimit të Drejtorëve është i përshtatshëm dhe dobishëm dhe që lidhet me të gjitha objektet e mësipërme apo konsiderohen se direkt apo indirekt rrisin vlerën apo fitimin e shoqërisë.
- (6) të blejë, të fitojë me dhurim, të marrë me qira apo nën-qira apo të shkëmbejë, apo të fitojë apo posedojë çdo pasuri apo interes mbi toka, ndërtesa, të drejta, privilegje, koçesione, leje, liçenca, letra të tregtueshme, dhe pasuri të luajtshme apo të paluajtshme të çdo lloji (edhe të ngarkuara me hipotekë apo barrë) të nevojshëm apo të përshtatshëm për nevojat e aktivitetit të shoqërisë apo të çdo dege apo filiali të saj, të cilët mund të rrisin vlerën e çdo prone të shoqërisë.
- (7) të ndërtojë, mirëmbajë, drejtojë, rindërtojë, ndryshojë, zgjerojë, riparojë, përmirësojë, adaptojë, furnizojë, dekorojë, kontrollojë, shembë, zëvendësojë dyqane, zyra, apartamente, vepra energjitike apo ujore, apartamente, panaire, fabrika, uzina, apo struktura të çdo tipi, të cilat mund të konsiderohen nga shoqëria si të përshtatshme për qëllimet e shoqërisë, si dhe të kontribuojë apo të asistojë apo të marrë pjesë në ndërtimin, përmirësimin, mirëmbajtjen, drejtimin e tyre.
- (8) të përmirësojë, menaxhojë, kontrollojë, kultivojë, zhvillojë, shfrytëzojë, shkëmbejë, japë me qira apo të hipotekojë, verë barrë, shesë, disponojë, dhurojë, japë të drejta dhe privilegje në lidhje me çdo pronë, aset dhe të drejta të shoqërisë, apo mbi ato në të cilat shoqëria ka interes dhe të marrë masa për reklamimin e aktiviteteve dhe produkteve të shoqërisë sic do të konsiderohet e arsyeshme.
- (9) të prodhojë, riparojë, importojë, blejë, shesë, eksportojë, japë me qira dhe në përgjithësi të tregtojë apo të merret me të gjitha llojet e aksesorëve, artikujve, aparaturave, fabrikave, makinerive, veglave, mallrave, pasurive, të drejtave apo sendet e çdo lloji, të cilat mund të përdoren apo trajtohen nga shoqëria dhe që lidhen me objektet e saj.
- (10) të përdorë për ndërtim apo qëllime të tjera, japë me qira apo nën-qira, të transferojë apo japë liçenca, vejë barrë apo hipotekë, të gjithë apo pjesë të pasurisë së paluajtshme të shoqërisë apo mbi çdo të drejtë që lidhet me to apo për të cilat shoqëria ka interes, sic do të konsiderohet e arsyeshme nga shoqëria.
- (11) të blejë apo fitojë, të gjithë apo pjesë të aktivitetit, aseteve, pronave dhe detyrimeve të ndonjë shoqërie, shoqate, ortakërie apo personi, të themeluar me



objekt plotësisht apo pjesërisht të ngjashëm me objektin e shoqërisë, apo që kryejnë apo që synojnë të kryejnë çdo aktivitet për të cilin është e autorizuar shoqëria, apo që posedojnë pasuri të përshtatshme për qëllimet e shoqërisë dhe të angazhohet, kryejë apo likujdojë çdo aktivitet që lidhet me të, të paguajë me para në dorë, emetojë aksione, marrë përsipër detyrime apo fitojë çdo interes.

- (12) të aplikojë dhe të marrë, blejë apo fitojë çdo skicim, markë, patentë, të drejtë patente apo shpikje, të drejtë autori apo procese sekrete, të cilat mund të jenë të dobishme për objektin e shoqërisë si dhe të japë licenca dhe t'i përdorë ato.
- (13) të paguajë të gjitha kostot, tarifatat dhe shpenzimet që lidhen me promovimin, formimin dhe krijimin e shoqërisë, apo të cilat do të konsiderohen nga shoqëria se bëjnë pjesë në shpenzimet paraprake që do të kryhen para themelimit dhe që lidhen me këtë të fundit, duke përfshirë tarifatat profesionale dhe kostot e reklamimit, tatimet, komisionet, printimet dhe kancelaritë, rrogat e punonjësve dhe shpenzime të tjera të ngjashme që kanë të bëjnë me krijimin dhe funksionimin e agjencive, bordeve lokale apo administrimit lokal apo organeve të tjera, apo shpenzime që lidhen me çdo aktivitet që kryhet para themelimit, të cilat do të merren përsipër nga shoqëria.
- (14) me emetimin e aksioneve apo letrave me vlerë të shoqërisë, të punësojë brokera, agjentë komisionerë dhe të ofrojë shpërblime për shërbimet e ofruara nga këto persona duke i paguar me para në dorë apo me emetim aksionesh apo letrash me vlerë të shoqërisë, apo duke i ofruar të drejta parablerje mbi to, apo sic mund të parashikohet nga ligji.
- (15) të marrë hua, ngrejë fonde apo sigurojë detyrime (të shoqërisë apo të ndonjë personi tjetër) me kushte dhe afate që do të konsiderohen si të përshtatshme, duke përfshirë emetimin e letrave me vlerë, vënien e hipotekave apo garancive të tjera, të bazuara mbi të gjitha apo pjesë të pronave apo të drejtave të shoqërisë, duke përfshirë kapitalin e saj, apo pa garanci, dhe mbi bazën e atyre kushteve që do të konsiderohen si të përshtatshme.
- (16) Të japë para me hua dhe kredi në favor të çdo personi, firme apo shoqërie; të garantojë apo dëmshpërblejë me pagim parash apo përmbushjen e kontratave apo detyrimeve për çdo person, firmë apo shoqëri; të sigurojë apo të marrë përsipër, me co mënyrë, ripagimin e parave të dhëna hua si dhe detyrimet e marra përsipër nga çdo person, firmë apo shoqëri; si dhe të ndihmojë çdo person apo shoqërie sic do të konsiderohet e arsyeshme.
- (17) të tërheqë, ekzekutojë, emetojë, pranojë, të bëjë zbritje dhe të negociojë kambiale, premtim pagesash, si dhe instrumenta të tjerë të negociueshëm dhe të transferueshëm.
- (18) të pranojë para me depozitë, me apo pa interes.
- (19) të japë me hua para, me ato garanci që mund të konsiderohen si të përshtatshme.
- (20) të investojë menjëherë paratë e shoqërisë që nuk përdoren në ato mënyra që mund të konsiderohen si të përshtatshme nga Drejtorët.

- (21) të emetojë apo garantojë emetimin apo pagimin e interesave, aksioneve, apo letrave të tjera me vlerë apo detyrimeve të shoqërisë dhe të paguajë apo ofrojë brokerage, komision në lidhje me këtë çështje.
- (22) të fitojë me nënshkrim, blerje apo veprime të ngjashme, si dhe të pranojë, marrë, shesë çdo lloj aksioni, letre me vlerë apo interesa në shoqëri të tjera dhe ndërmarrje të çdo lloj natyre.
- (23) të emetojë si dhe japë plotësisht apo pjesërisht aksione të kapitalit të shoqërisë apo të emetojë letra me vlerë apo të kryejë pagesa për pasuri të luajtshme apo të paluajtshme të blera apo të fituara nga shoqëria apo çdo shërbim të ofruar për shoqërinë si dhe të shpërblejë me para në dorë çdo person, firmë apo shoqëri që ofron shërbime për shoqërinë apo të japë dhurata këtyre personave.
- (24) të krijojë kudo në botë, degë, zyra rajonale, agjenci dhe borde lokale si dhe të menaxhojë dhe mbyllë ato.
- (25) të ofrojë për mirëqënien e personave të punësuar nga shoqëria, apo ish-punonjësit e shoqërisë apo pasardhësit e tyre në biznes apo për punonjësit e çdo shoqërie të lidhur apo të kontrolluar, si dhe për bashkëshortet dhe vejtshat, personave të varur apo familjet e këtyre personave, duke i dhënë para, pensione si dhe pagesa të tjera, (duke përfshirë pagesa për sigurime dhe premio) si dhe duke ngritur ndihma, skema fondesh apo përfitimesh për këta persona si dhe për institucione të tjera fetare, shkencore, kombëtare apo me objekt të çfarëdoshëm.
- (26) herë pas here të nënshkruajë dhe të kontribujë me bamirësi apo aktivitete me karakter publik, suporti i të cilave sipas gjykimit të shoqërisë, tenton të rrisë reputacionin apo popullaritetin midis punonjësve, klientëve apo publikut.
- (27) të realizojë bashkarisht me biznese, bashkime interesash, ortakëri apo nëpërmjet bashkimit me shoqëri, ortakëri apo persona të tjerë, të cilat kryejnë aktivitete brenda objektit të shoqërisë.
- (28) të krijojë, promovojë dhe asistojë çdo shoqëri me qëllim që të fitojë çdo pronë apo objekt të këtyre shoqërive apo për çdo lloj qëllimi tjetër i cili direkt apo indirekt është në përfitim të shoqërisë.
- (29) të aplikojë, promovojë dhe marrë çdo dokument, konçesion, të drejtë, privilegj, licencë apo leje me qëllim që të mundësohet shoqëria të realizojë objektin e saj, apo për çdo lloj qëllimi i cili mund të konsiderohet si i nevojshëm, si dhe të ndjekë çdo procedurë apo aplikim i cili as direkt apo indirekt nuk bie ndesh me interesat e shoqërisë si dhe të hyjë në marrëveshje me çdo Qeveri apo Autoritet, organ qëndror apo lokal, që lidhen me realizimin e objektit të shoqërisë.
- (30) të shesë, disponojë, vejë hipotekë, barrë, të japë të drejta apo transferojë biznese, pasuri dhe sipërmarrje të shoqërisë apo pjesë të tyre sic do të konsiderohet e pranueshme nga shoqëria.
- (31) të pranojë aksione, vënie hipoteke apo garanci të tjera prej shoqërive të tjera.

- 
- (32) të shpërndajë, siç do të vendoset, asete të shoqërisë, ndërmjet aksionerëve të saj dhe veçanërisht aksionet apo garanci të tjera të shoqërive të tjera që i përkasin kësaj shoqërie apo mbi të cilat kjo shoqëri mund të disponojë.
- (33) të përmbushë të gjitha çështjet e autorizuara me këtë akt në çdo cep të botës ose vetëm ose bashkë me, shoqëri, nën-kontraktorë apo agjentë, si dhe me çdo shoqër tjetër, firmë apo person, apo nëpërmjet çdo agjenti apo nën-kontraktori.
- (34) të sigurojë regjistrimin dhe njohjen e shoqërisë në çdo vend; të veprojë si sekretar, menaxher, drejtor apo shoqëri thesari për çdo shoqëri tjetër.
- (35) Në përgjithësi të kryejë të gjitha ato veprime që mund t'i nevojiten shoqërisë për realizimin e objektit të saj.

Pavarësisht nga ato që janë parashikuar në objektin apo në dispozitat e mësipërme, shoqëria (a) nuk do të ofrojë ndonjë shërbim financiar përveç se ato në favor të aksionerëve të saj apo organeve të shoqërisë; (b) nuk do të marrë përsipër, direkt apo indirekt, ndonjë detyrim nga publiku, në formën e depozitave, sigurimeve apo detyrimeve të tjera dhe (c) nuk do të veprojë si një shoqëri profesionale e besuar. (Për qëllimet e mësipërme termi “shërbime financiare” do të thotë që të merresh me investime, dhënie këshillash mbi investimet apo krijimi dhe drejtimi i skemave investuese kolektive. Termi “investime” do të thotë aksione, detyrime dhe letra me vlerë të qeverisë apo të publikut, garanci, çertifikata që përfaqësojnë letra me vlerë, njësi në skema kolektive investuese, dhe kontrata afat-gjata sigurimi. Termi “publik” nuk përfshin institucionet bankare apo kredituese, aksionerët e shoqërisë apo organet e saj në shoqëritë e grupit. Termi “depozita” nuk përfshin shumat e marra me kushte të cilat i referohen ofrimit të mallrave dhe shërbimeve përveç “shërbimeve financiare” siç përcaktohet më lart. Termi “borxh” nuk përfshin kreditë e marra në lidhje me ofrimin e mallrave dhe shërbimeve. Termi “profesionist i besuar” do të thotë një shoqëri e cila ofron shërbime besimi për publikun e gjerë, e cila synon t'i përfaqësojë në biznese besimi, psh. krijimin, sipërmarrjen, ekzekutimin dhe administrimin e trusteve si dhe reklamimin e faktit nëse ajo është e kualifikuar dhe/ose autorizuar në bazë të ligjit apo nga praktika për të ofruar shërbime besimi për publikun).

Aktivitetet e parashikuara në secilën prej pjesëve të këtij paragrafi do të interpretohen në mënyrën më të gjerë të mundshme, dhe përveçse kur parashikohet ndryshe nga konteksti, ato nuk do të kufizohen nga ndonjë referim i ndonjë objekti tjetër apo objektet e parashikuara në paragrafin e mësipërm. Asnjë prej klauzolave apo objektet e specifikuara apo kompetencat e sipërcituara nuk do të konsiderohen si aksesorë të objekteve apo kompetencave të parashikuara në dispozita të tjera. Shoqëria do të ketë kompetencë të plotë për të ushtruar tërësisht apo pjesërisht kompetencat me qëllim që të arrijë të gjitha objektivat e dhëna e të parashikuara në secilën prej nën-paragrafët në fjalë.

Për aq sa aksionet e shoqërisë zotërohen nga individët apo personat juridik jo resident në Republikën e Qipros, shoqëria nuk do të kryejë asnjë aktivitet brenda Republikës përveçse në bazë të lejes së bankës Qëndrore të Qipros dhe në përputhje me kushtet e kësaj leje.

4. Përgjegjësia e aksionerëve është e kufizuar.

5. Kapitali i shoqërisë është 10.000 pound qipriot, ndarë në 10.000 aksione (dhjetëmijë) me një vlerë nominale prej 1 paund qipriote secili. Shoqëria do të ketë të drejtë të emetojë aksione të tjera, me të drejtë preferenciale apo të posaçme me kushte që lidhen me dividendët, ripagimin e kapitalit, votimin etj.

Ne të nënshkruarit, dëshirojmë të themelojmë një shoqëri në përputhje me këtë akt themelimi, dhe pranojmë të marrim aq aksione të kapitalit të shoqërisë të cilat tregohen në krahasim të emrave tanë.

**EMRAT, ADRESAT DHE
PËRSHKRIMI I NËNSHKRUESVE**

Numri i Aksioneve

ABACUS (CYPRUS) LIMITED
Shoqëri me aksione me përgjegjësi të kufizuar
1st floor
Julia House
3 Themistocles Dervis Street
Nicosia – Cyprus
Numri i regjistrimit: 14003

1000
njëmijë
aksione

LIGJI PËR SHOQËRITË, KAPITULLI 113

SHOQËRI AKSIONERE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

STATUTI

I SHOQËRISË DALEWEST LIMITED

INTERPRETIM

1. Ne këtë Statut:

“Qipro” do të thotë Republika e Qipros.

“Ligji” do të thotë Ligji i Shoqërive Tregtare, Kapitulli 113, ose çdo ligj tjetër që e zëvendëson apo modifikon atë.

“vula” do të thotë vula e përbashkët e Shoqërisë.

“sekretari” do të thotë çdo person i emëruar për të kryer detyrat e sekretarit të shoqërisë.

Shprehja “me shkrim”, përveç rasteve kur duket qartë se përdoret me qëllim të kundërt, do të interpretohet sikur përfshin të gjithë referimet që bëhen për “shtypin”, “litografinë”, “fotografinë”, dhe mënyra të tjera të përfaqësimit apo riprodhimit të fjalëve në mënyrë të dukshme.

Me përjashtim të rasteve kur konteksti kërkon të kundërtën, fjalët ose shprehjet që përdoren në këtë statut do të kenë të njejtin kuptim si ato që përdoren nga Ligji ose ndryshimet ligjore të tij që janë në fuqi në datën kur ky statut e lidh përfundimisht shoqërinë.

PËRJASHTIM I TABELËS “A”

2. Rregullat që parashikon Tabela “A” në Shtojcën e Parë të ligjit nuk zbatohen, me përjashtim të rastit kur ato përsëriten në apo parashikohen nga ky statut.

PARAPRAKE

3. shoqëria është një shoqëri private (me përgjegjësi të kufizuar) dhe si rrjedhojë:
- (a) e drejta për të transferuar aksionet është e kufizuar në përputhje me dispozitat e këtij statuti;
 - (b) numri i aksionerëve të shoqërisë (me përjashtim të personave të cilat janë në marrëdhënie pune me shoqërinë dhe të personave të cilët, duke qenë më përpara në marrëdhënie pune me shoqërinë, kanë qenë aksionerë të shoqërisë gjatë periudhës së punësimit dhe kanë vazhduar të mbeten aksionerë të shoqërisë pas përfundimit të marrëdhënies të punës) është i kufizuar në pesëdhjetë. Sidoqoftë, nëse dy ose më shumë persona zotërojnë bashkërisht një ose më shumë aksione të shoqërisë, ata do të trajtohen si një aksioner i vetëm;
 - (c) çdo ftesë e bërë publikut për të nënshkruar aksione apo obligacione të shoqërisë është e ndaluar;


- (d) shoqëria nuk ka të drejtë të emetojë aksione garante për prurësin.


BIZNESI

4. Shoqëria do të përballojë të gjithë shpenzimet paraprake dhe të gjithë shpenzimet e tjera për të lidhur, adoptuar dhe zbatuar ose ndërmarrë dhe vazhduar (me të gjithë ndryshimet, nëse ka, për të cilat palët kontraktuese do të bien dakort bashkërisht dhe që do të miratohen nga këshilli drejtues), çdo marrëveshje ose biznes, ose punë e arritur apo e zhvilluar (sipas rastit) përpara themelimit të shoqërisë, siç do të vendoset nga vetë shoqëria.

KAPITALI SHOQËRISË DHE NDRYSHIMI I TË DREJTAVE

5. Aksionet janë në dispozicion të shoqërisë e cila, me anë të një vendimi të asamblesë së zakonshme të aksionerëve, mund të vendosë të emetojë aksione të reja ose ti tjetërsojë ato në një mënyrë tjetër, duke pasur parasysh dispozitat e nenit 3, dhe të gjithë dispozitat në vijim, të ato persona, në atë kohë dhe në mënyrë të përgjithshme sipas kushteve dhe rregullave që asambleja e aksionerëve mund të gjykojë të arsyeshme, dhe me kushtin që aksionet nuk mund të emtohen me ulje, përveç rasteve të parashikuara në nenin 56 të Ligjit.
6. Përveç rasteve kur asambleja e aksionerëve ka vendosur të kundërtën, pjesët e kapitalit themeltar që nuk janë emetuar dhe nuk janë shpërndarë dhe të gjithë aksionet e reja që mund të krijohen nga shoqëria herë pas here, do t'i ofrohen, përpara se të nënshkruhen, aksionerëve ekzistues, sipas raportit më të afërt të mundur me numrin e aksioneve të zotëruara nga aksionerët ekzistues. Oferta për nënshkrim do të bëhet nëpërmjet një njoftimi që do të përcaktojë numrin e aksioneve të ofruara, dhe duke vendosur një afat kohor, me përfundimin e të cilit, oferta, nëse nuk është pranuar, do të prezumohet e refuzuar dhe pas përfundimit të këtij afati ose me marrjen e deklaratës nga ana e personit të cilit i është bërë oferta për refuzimin e ushtrimit të së drejtës së përparësisë, shoqëria mund të tjetërsojë aksionet sipas mënyrës që ajo konsideron si më fitimprurëse për shoqërinë. Shoqëria ka gjithashtu të drejtë të tjetërsojë, sipas mënyrës së lartpërmendur, aksionet e reja ose aksionet e kapitalit themeltar, të cilat për arsye të përpjestimit të tyre me numrin e titullarëve të së drejtës së përparësisë siç është përmendur më lart, ose për arsye të ndonjë vështirësie tjetër në përpjestimin e këtyre aksioneve, nuk mund, sipas këndvështrimit të shoqërisë të ofrohen në mënyrë të përshtatshme aksionerëve në fjalë sipas procedurës së lartpërmendur.
7. Pa paragjykuar të drejtat e veçanta të akorduara paraprakisht aksionerëve ekzistues ose kategorive të aksioneve ekzistuese, të gjithë aksionet e shoqërisë mund të emtohen si aksione me përparësi, aksione me të drejta të kufizuara ose me të drejta të veçanta ose me të tilla kufizime, qoftë kjo përsa i përket dividendit, votimit, të ardhurave nga kapitali ose në një mënyrë tjetër sipas mënyrës që shoqëria mund të vendosë herë pas here me vendim të asamblesë së zakonshme.
8. Me kusht të zbatimit të nenit 57 të Ligjit, të gjithë aksionet me përparësi mund, në bazë të vendimit të asamblesë së zakonshme të aksionerëve, të emtohen sipas kushteve që parashikojnë se këto aksione duhet, ose sipas të drejtës së zgjedhjes së shoqërisë që vendos nëpërmjet vendimit të asamblesë së zakonshme të aksionerëve të shoqërisë mund, të riblenden sipas kushteve dhe procedurës që shoqëria ka të drejtë të përcaktojë përpara emetimit të aksioneve me anë të një vendimi të veçantë.

- 
9. Nëse në çdo kohë kapitali i shoqërisë është i ndarë në kategori të ndryshme aksionesh, të drejtat që lidhen me cilëndo kategori aksionesh (nëse nuk është parashikuar ndryshe në kushtet e emetimit të aksioneve të kësaj kategorie) mund, gjatë likuidimit të shoqërisë ose jo, të ndryshojnë në bazë të pëlqimit të dhënë me shkrim të aksionerëve që përfaqësojnë tre të katërtat e të gjithë aksioneve të emetuara për këtë kategori aksionesh, ose në bazë të vendimit të asamblesë së jashtëzakonshme të aksionerëve titullarë të kategorisë së aksioneve në fjalë. Dispozitat e këtij statuti për asamblenë e përgjithshme të aksionerëve zbatohen edhe për çdo asamble të aksionerëve të kategorive të veçanta të aksioneve, por në këtë rast quorum i kërkuar do të përbëhet prej të paktën dy aksionerësh të cilët zotërojnë ose përfaqësojnë me prokurë një të tretën e aksioneve të emetuara në kategorinë përkatëse dhe gjithashtu të gjithë zotëruesit e aksioneve të pranishëm ose të përfaqësuar me prokurë të kësaj kategorie gëzojnë të drejtën të kërkojë votimin.
10. Të drejtat që u janë akorduar zotëruesve të aksioneve të çdo kategorie aksionesh të emetuara me të drejta përparësie ose me të drejta të tjera do të prezumohen të ndryshuara, me përjashtim të rastit kur kushtet e emetimit të aksioneve të asaj klase parashikojnë ndryshe, me krijimin ose emetimin e aksioneve të tjera shtesë që do të kenë të njejtin rang me këto të fundit.
11. Shoqëria ka të drejtë të ushtrojë kompetencat e dhënies së një shpërblimi që parashikohet nga neni 52 i Ligjit, me kusht që përqindja e shumës së shpërblimit të paguar ose për të cilin është rënë dakort tu njoftohet sipas mënyrës së kërkuar nga ky nen dhe përqindja e shpërblimit të mos tejkalojë 10 përqind të vlerës së emetimit të aksioneve, në lidhje me të cilat paguhet ky shpërblim ose një shumë e barazvlefshme me 10 për qind të vlerës së emetimit të aksioneve (sipas rastit). Ky shpërblim mund të paguhet në të holla ose me shpërndarje aksionesh të shlyera pjesërisht ose totalisht ose të aksioneve të shlyera pjesërisht në mënyra të ndryshme. Shoqëria ka gjithashtu të drejtë të shpërblejë ndërmjetësit për emetimin e aksioneve sipas çdo mënyre tjetër të ligjshme.
12. Përveç përjashtimeve të parashikuara me ligj, askujt nuk do të njihet nga shoqëria si titullar i aksioneve që janë dhënë me kujdestari dhe shoqëria nuk do të jetë e lidhur apo e detyruar në asnjë mënyrë të njohë (edhe nëse merr njoftim për këtë) çfarëdo interesi në pronësi, të kushtëzuar, të ardhshëm ose të pjesshëm në aksionet e shoqërisë, interes në një pjesë të aksionit ose (me përjashtim të rasteve kur rregullat e këtij statuti ose ligji parashikon të kundërtën) osë të drejta të tjera mbi mbi çfarëdo aksioni me përjashtim të një të drejte themelore mbi tërësinë e tyre kundrejt aksionerit të regjistruar.
13. Çdo person që është regjistruar si aksioner i shoqërisë në regjistrin e aksionerëve ka të drejtë të marrë, pa pagesë, brenda dy muajve nga nënshkrimi ose regjistrimi i transferimit (ose çdo afat kohor tjetër i parashikuar në kushtet e emetimit) një certifikatë për të gjithë aksionet që ai zotëron, ose certifikata të ndryshme, secila për një ose më shumë aksione të tij kundrejt pagesës së një shume prej 12 ½ cents për çdo certifikatë shtesë osë për çdo shumë tjetër më të vogël sipas vendimit që administratorët mund të marrin herë pas here. Çdo certifikatë do të mbajë vulën e shoqërisë dhe do të përcaktojë aksionet të cilave i referohet dhe shumën e vlerës së shlyer. Në lidhje me një aksion ose aksione të zotëruara bashkërisht nga shumë persona, shoqëria nuk është e detyruar të lëshojë më shumë se një certifikatë dhe dorëzimi i një certifikate për një aksion të një ose më shumë titullarë të përbashkët do të jetë i mjaftueshëm për të gjithë titullarët.

- 
14. Nëse një certifikatë aksionesh prishet, humbet apo shkatërrohet, certifikata mund të rinovohet kundrejt pagesës së shumëzës prej 12 ½ cents osë të një shume tjetër më të vogël dhe me të tilla kushte (nëse ka) si mund të vërtetohen dhe dëshmshpërblimi si dhe shlyerja e shpenzime të bëra nga vetë shoqëria për hetimin dhe mbledhjen e provave sipas asaj që administratorët do të vlerësojnë si të përshtatshme.
15. Shoqëria nuk ofron, në mënyrë direkte ose tërthorazi, dhe qoftë nëpërmjet një huaje, garancie apo vendosjes së një barre siguruese, apo në një mënyrë tjetër, asistencë financiare me qëllim të, ose në lidhje me, blerjen ose nënshkrimin e realizuar ose që do të realizohet në të ardhmen, të aksioneve të shoqërisë ose të shoqërisë holding të saj, dhe gjithashtu nuk do të japë hua për çfarëdo qëllimi në lidhje me garancinë e aksioneve ose të aksioneve të shoqërisë së saj holding, por asgjë në këtë statut nuk ndalon transaksionet e parashikuara në nenin 53 (1) të ligjit.

PRIVILEGJI

16. Shoqëria do të gëzojë një të drejtë preferimi të radhës së parë me përparësi mbi të gjithë privilegjet e tjera mbi çdo aksion për të gjithë shumatat në të holla (të kërkueshme në atë kohë ose jo) të cilat derdhen për shlyerjen e këtij aksioni ose duhet të shlyhen në një periudhë kohe të caktuar dhe shoqëria do të ketë gjithashtu një privilegj të radhës së parë me përparësi mbi të gjithë privilegjet e tjera mbi të gjithë aksionet e e rregjistruara në emrin e një personi të vetëm për të gjithë shumatat që aktualisht ai ose pasuria e tij i detyrohen shoqërisë; megjithatë drejtorët mund ti deklarojnë në çdo kohë aksionet si totalisht ose pjesërisht të lira nga detyrimet që rrjedhin nga dispozitat e këtij statuti. E drejta e preferimit e shoqërisë mbi një aksion, nëse ekziston, do të mbulojë edhe dividendin e shpërndarë për këtë aksion.
17. Shoqëria ka të drejtë të shesë, sipas mënyrës që gjykohet e përshtatshme nga drejtorët, të gjithë aksionet mbi të cilat ajo gëzon një të drejtë preferimi, por asnjë shitje nuk do të bëhet, përveç rastit kur një shumë për të cilën ekziston e drejta e preferimit është tashme e kërkueshme dhe jo deri në përfundimin e afatit prej katërmëdhjetë ditësh pas dhënies së njoftimit me shkrim, që përcakton dhe kërkon shlyerjen e asaj pjese të shumëzës në lidhje me të cilën ekziston e drejta e preferimit siç është e kërkueshme aktualisht, njoftim i cili i jepet aksionerit të rregjistruar që rezulton si titullari aktual i aksionit, ose titullarit tjetër që e ka përfutur aksionin për arsye vdekjeje apo falimentimi.
18. Për të ekzekutuar shitjen, drejtorët mund të autorizojnë një person për t'ia transferuar aksionet e shitura blerësit. Blerësi do të rregjistrohet si zotëruesi i aksioneve të përfshira në transferim dhe nuk do të ketë asnjë detyrim për ndjekjen e përdorimin të shumëzës së blerjes dhe asnjë parregullsi apo pavlefshmëri gjatë procedurës në lidhje me shitjen nuk dëmton titullin e tij.
19. Të ardhurat e shitjes i kalojnë shoqërisë dhe përdoren për shlyerjen e shumëzës për të cilën ekziston e drejta e preferimit, dhe shuma e mbetur, nëse ka, do të kthehet (me përjashtim të rastit kur ekziston një e drejtë e preferimit e ngjashme për shumata të cilat nuk janë ende të kërkueshme si e drejta e preferimit mbi aksionet përpara shitjes) personit që është zotëruesi i aksioneve në datën e shitjes.

THIRRJE PËR SHLYERJE AKSIONESH

20. Drejtorët kanë të drejtë herë pas here tu bëjnë thirrje aksionerëve për derdhjen e shumave të pashlyera mbi vlerën e aksioneve (për vlerën nominale të aksioneve ose për primin) dhe të pa-shlyera në periudha të caktuara në përputhje me kushtet e nënshkrimit dhe çdo aksioner është i detyruar (me kusht që të ketë marrë një njoftim paraprak prej të paktën katërmëdhjetë ditësh ku caktohet data ose datat dhe vendi i pagesës) ti derdhë shoqërisë në datën ose datat dhe vendin e caktuar shumë e parashikuar në thirrjen për shlyerje aksionesh. Thirrja mund të tërhiqet ose të shtyhet sipas vendimit të drejtorëve.
21. Thirrja do të prezumohet si e kryer në kohën kur është marrë vendimi i drejtorëve për autorizimin e thirrjes dhe mund të paguhet me këste. .
22. Titullarët e përbashkët të një aksioni do të jenë përgjegjës bashkërisht dhe veçanërisht për shlyerjen e vlerës së aksioneve të kërkuar nga thirrja dhe në lidhje me të.
23. Nëse kërkohet derdhja e një shume mbi vlerën e aksioneve që nuk ishin shlyer më parë ose që nuk ishin shlyer në ditën e caktuar për derdhjen, personi mbi të cili rëndon detyrimi do të paguajë interes mbi shumën duke filluar nga dita e caktuar për derdhjen e saj deri në afatin e derdhjes përfundimtare me një përqindje që nuk tejkalon 8 për qind në vit siç përcaktohet nga drejtorët, megjithatë drejtorët janë të lirë të falin pagimin e interesit tërësisht ose pjesërisht.
24. Çdo derdhje e cila sipas kushteve të emetimit të aksionit është e kërkueshme kur aksionet shpërndahen ose në një datë tjetër të caktuar, mbi vlerën nominale ose primin e aksioneve, prezumohet për qëllimet e këtij statuti të jetë kërkuar sipas thirrjes së rregullt dhe është e kërkueshme në datën në të cilën sipas kushteve të emetimit kjo shumë do të bëhet e kërkueshme, dhe në rastin e mosekzekutimit të gjithë dispozitat e këtij statuti në lidhje me shlyerjen e interesit dhe të shpenzimeve, sekuestron, etj zbatohen në të njëjtën sikur derdhja të ishte e kërkueshme në bazë të një thirrje të bërë rregullisht dhe të njoftuar. Gjatë emetimit të aksioneve, drejtorët kanë të drejtë të dallojnë ndërmjet aksionerëve për shumën dhe afatet e derdhjes.
25. Drejtorët kanë të drejtë, nëse e konsiderojnë të përshtatshme, të marrin nga çdo aksioner i gatshëm të bëjë derdhjen, të gjithë apo pjesë të shumave që mbeten për tu shlyer mbi vlerën e aksioneve të zotëruara nga ky aksioner të gjitha shumat që nuk janë kërkuar e nuk janë derdhur, të paguajnë interes mbi njërin ose të gjithë shumat e derdhura në këtë mënyrë (deri në kohën kur shuma në fjalë, me përjashtim të parapagimit, bëhet e kërkueshme) me një përqindje që nuk tejkalon (me përjashtim të rastit kur asambleja e aksionerëve të shoqërisë vendos ndryshe) 5 për qind në vit, sipas marrëveshjes së lidhur midis drejtorëve dhe aksionerëve që e kanë bërë këtë parapagim.


TRANSFERIMI I AKSIONEVE

26. Dokumenti i transferimit të çdo aksioni ekzekutohet nga dhe në emër të transferuesit dhe të transferuarit, dhe transferuesi konsiderohet si titullar i aksionit derisa emri i transferuesit të shënohet në regjistrin e aksionerëve në lidhje me transferimin.
27. Duke qënë kufizimet e këtij statuti sipas fushës së zbatimit të tyre, çdo aksioner ka të drejtë të transferojë të gjitha ose cilëndo nga aksionet e tij nëpërmjet një dokumenti me shkrim sipas formës së zakonshme ose të përgjithshme ose çdo formë tjetër që drejtorët mund të miratojnë.

28. Drejtorët mund të rregjistrojnë transferimin e një aksioni te një person që ata nuk e miratojnë dhe ata kanë gjithashtu të drejtë të refuzojnë të rregjistrojnë transferimin e një aksioni mbi të cilin shoqëria ka një të drejtë përparësie.
29. Drejtorët mund të refuzojnë njohjen e dokumentit të transferimit, me përjashtim të rasteve kur:
- (a) një tarifë prej 12 ½ cents ose një shumë më e vogël siç mund të kërkoher herë pas here nga drejtorët i është paguar shoqërisë për transferimin;
 - (b) dokumenti i transferimit shoqërohet nga çertifikatat e aksioneve respektive, dhe çdo provë tjetër që drejtorët mund të kërkojnë në mënyrë të arsyeshme për të verifikuar të drejtën e transferuesit për të bërë transferimin; dhe
 - (c) dokumenti i transferimit është bërë vetëm për një kategori aksionesh.
30. Nëse drejtorët refuzojnë të rregjistrojnë një transferim, brenda dy muajsh pas datës në të cilën transferimi i është paraqitur shoqërisë, shoqëria duhet ti dërgojë të transferuarit një njoftim për refuzimin.
31. Rregjistrimi i transferimit mund të pezullohet në kohën dhe për periudhat që drejtorët mund të vendosin herë pas here, duke pasur parasysh se rregjistrimi nuk do të pezullohet për më shumë se 30 ditë në vit.
32. Shoqëria ka të drejtë të kërkojë pagimin e një tarife që nuk është më e lartë se 12 ½ cents për rregjistrimin e çdo testamenti, shkrese administrative, çertifikate vdekjeje ose martese, prokure ose dokumenti tjetër.
33. Nenet 26 dhe 27 të statutit do të lexohen së bashku me nenin 34.
- 34.
- (a) Për qëllimet e këtij statuti, në rastin kur një person ka një të drejtë të pakushtëzuar të rregjistrohet si titullari i një aksioni, ky person dhe jo titullari i rregjistruar i aksionit do të prezumohet si aksioner i shoqërisë për këtë aksion.
 - (b) Me përjashtim të rasteve të parashikuara këtu, asnjë aksion i shoqërisë nuk mund të transferohet nëse dhe derisa të drejtat e përparësisë që parashikohen në vijim nuk janë përmbushur.
 - (c) Çdo anëtar që dëshëron të transferojë një aksion ose aksione (në vijim i përmendur si shitësi) do të njoftojë shoqërinë me shkrim mbi qëllimin e tij (në vijim e përmendur si njoftimi i transferimit). Duke qënë sa më lart, njoftimi i transferimit i jep shoqërisë titullin e përfaqësuesit të shitësit për shitjen e aksionit ose të aksioneve të përcaktuara aty (në vijim aksionet në fjalë) në një ose më shumë grupe, sipas vendimit të drejtorëve, të aksionerit të ndryshëm nga shitësi, sipas çmimit të rënë dakort ndërmjet shitësit dhe anëtarëve të tjerë të shoqërisë, ose, në rast mosmarrëveshjeje, sipas çmimit të përcaktuar nga eksperti kontabël i autorizuar i shoqërisë në funksion, i cili me nënshkrimin e tij vërteton se çmimi përfaqëson vlerën e ndershme të aksioneve të rënë dakort midis një shitësi që dëshëron të shesë dhe një blerësi që dëshëron të blejë. Njoftimi i transferimit mund të përmbajë një dispozitë sipas së cilës, me përjashtim të rastit kur aksionet që përbëjnë objektin e transferimit janë shitur nga

shoqëria në përputhje me këtë statut, asnjë prej tyre nuk do të shitet dhe të gjithë këto dispozita janë të detyrueshme për shoqërinë.

- (d) Nëse eksperti kontabël i autorizuar duhet të vërtetojë çmimin e ndershëm si më lart, shoqëria duhet ti dorëzojë, sapo të marrë kopjen nga eksperti kontabël i autorizuar, një kopje të njëzuar me origjinalin shitësit i cili ka të drejtë, duke njoftuar shoqërinë me shkrim brenda dhjetë ditëve të shërbimit që i është ofruar siç përmendet në kopjen e njëzuar me origjinalin, të anullopë kompetencat e shoqërisë për të shitur aksionet në fjalë. Shpenzimet për marrjen e çrtifikatës do të përballohen nga shoqëria, përveç rastit kur shitësi njofton shoqërinë për anulimin e lartpërmendur në të cilin rast shitësi do ti përballopë vetë shpenzimet.
- (e) Me përcaktimin e çmimit si më lart dhe me kusht që shitësi të mos njoftojë për anulimin siç u përmend më lart, shoqëria do të informon me shkrim, që nga ky moment, çdo aksioner tjetër përveç shitësit dhe përveç aksionerëve të cilët zotërojnë aksione në cilësinë e punonjësve të shoqërisë, mbi numrin dhe çmimin e aksioneve dhe fiton çdo aksioner të aplikojë me shkrim pranë shoqërisë brenda njëzetentjë ditëve nga data e dërgimit të njoftimit (datë e cila do të indikohet ne njoftim) për numrin maksimal të aksioneve në fjalë (duke qënë të gjitha ose cilido prej tyre) siç do të përcaktohet ne aplikimin e tij.
- (f) Nëse aksioneri në fjalë do të aplikojnë brenda periudhës së njëzetentjë ditëve për të gjithë ose (me përjashtim të rastit kur njoftimi i transferimit parashikon të kundërtën) cilindo nga aksionet, drejtorët do ti shpërndajnë këto aksione te ose midis aplikuesve dhe në rastin vendimi do të merret përpjestueshmërisht (aq afërsisht sa të jetë e mundur) në bazë të numrit të aksioneve në kapitalin e shoqërisë (me përjashtim të aksioneve të zotëruara nga punonjësit e shoqërisë) sipas rregjistrimit ose të drejtës së pakushtëzuar që gëzojnë për tu rregjistruar si aksioner i shoqërisë, me kusht që asnjë aplikant të jetë i detyruar të marrë më shumë se numri maksimal i aksioneve të indikuara nga ai siç u përmend më lart; më tutje shoqëria do të njoftojë për shpërndarjen e aksioneve (në vijim i referuar si njoftimi i shpërndarjes) te shitësi dhe te personat të cilëve u janë shpërndarë aksionet dhe do të përcaktojnë në këtë njoftim vendin dhe kohën (jo më herët se katërmëdhjetë dhe jo më vonë se njëzetentjë ditë pas datës së njoftimit) e kompletimit të shitjes të aksioneve.
- (g) Shitësi është i detyruar t'ia transferojë aksionet e përfshira në njoftimin e shpërndarjes blerësve të përmendur aty në kohën dhe vendin e përcaktuar në njoftim; nëqoftëse ai nuk vepron në këtë mënyre, kryetari i (këshillit drejtues) shoqërisë ose një person tjetër i emëruar nga drejtorët do të prezumohet si perfaqësuesi ligjor i shitësit me fuqi të plota për të kryer, kompletuar dhe zbatuar, në emër dhe për llogari të shitësit, transferimin e aksioneve tek blerësit e tyre kundrejt pagesës së çmimit të tyre ndaj shoqërisë. Me pagesën e çmimit që i bëhet shoqërisë, blerësi prezumohet të ketë marrë një titull të vlefshëm dhe pas kryerjes dhe zbatimit të transferimit blerësi ka të drejtë të kërkojë rregjistrimin e emrit të tij në rregjistrin e aksionerëve si zotërues i rregullt tyre në bazë të transferimit të aksioneve. Duke filluar nga ky moment, shoqëria do të derdhë çmimin e përfutur nga transferimi në një llogari bankare në emrin e saj dhe do të ruaje këtë shumë në cilësinë e dorëzanësit të shitësit.
- (h) Gjatë gjashtë muajve në vijim pas përfundimit të afatit prej njëzetentjëditësh të përmendur më lart në paragrafin (e) të këtij statuti, shitësi është i lirë (megjithatë me përjashtim të zbatueshmërisë së nenit 28) të transferojë te cilido person i tretë me çfarëdo çmimi (i cili sidoqoftë nuk mund të jetë më i ulët se çmimi i caktuar në përputhje me paragrafin (c) të këtij statuti) çdo aksion që nuk është shpërndarë nga drejtorët në njoftimin e shpërndarjes.



Nëse shitësi ka parashikuar në njoftimin e transferimit se nëqoftëse të gjithë aksionet e përfshira nuk shiten në përputhje me statutin, asnjëra prej tyre nuk do të shitet, shitësinuk ka të drejtë, përveç rastit kur ka marrë pëlqimin me shkrim të të gjithë aksionerëve të shoqërisë, të shesë vetëm një pjesë të aksioneve të përfshira në njoftimin e transferimit.

- (i) Çdo aksion mund ti transferohet bashkëshortit, fëmijës, prindit ose trashëgimtarit të një radhe më të largët si motra, vëllai i atij aksioneri ose një shoqërie të zotëruar ose të kontrolluar në mënyrë fitimprurëse nga ky aksioner dhe çdo aksion i një aksioneri të vdekur mund t'u transferohet nga përfaqësuesit e tij personalë bashkëshortit ose bashkëshortes së vejë, fëmijës, prindit ose trashëgimtarit të një radhe më të largët si motra, vëllai i atij aksioneri dhe aksionet e dhëna në kujdestari në emër të kujdestarit të një anëtarit të vdekur kanë të drejtë ti transferohen, pas ndryshmit të kujdesarëve, kujdestarëve të testamentit që janë të ngarkuar me këtë detyrë në atë kohë: dhe në rastin kur aksioneri është një subjekt juridik, ky aksioner ka të drejtë t'ia transferojë aksionet filialit të tij, shoqërisë holding ose një shoqërie të kontrolluar nga shoqëria holding. Të drejtat e përparësisë të parashikuara nga ky statut nuk zbatohen (lindin) në rastin e transferimit apo të transferimeve të përmendura këtu dhe neni 28 do të lexohet së bashku me këtë paragraph.

TRANSFERIMI I AKSIONEVE

35. Në rastin e vdekjes së një aksioneri, aksioneri ose aksionerët e tjerë në rastin kur aksioni ishte një pronë e përbashkët dhe përfaqësuesi ligjor personal i të vdekurit në rastin kur aksioneri i vdekur ishte titullar i vetëm, është i vetmi person që njihet nga shoqëria si personi që zotëron një titull të vlefshëm mbi aksionet; por asgjë e parashikuar këtu nuk e liron trashëgimninë pasurore nga barrat ose detyrimet që rëndojnë mbi të dhe që trashëgimlënësi ka ndërmarrë bashkërisht me persona të tjerë.
36. Çdo personi të cilit i kalon titulli mbi një aksion për arsye të vdekjes ose të falimentimit të një aksioneri ka të drejtë, pas prezantimit të provës së titullit të tij që mund të kërkohet herë pas here siaps rregullave nga drejtorët dhe në përputhje me parashikimet në vijim, të zgjedhë të rregjistrohet personalisht si titullar i aksionit ose të emërojë një person tjetër që të rregjistrohet si personi të cilit i transferohet aksioni, por në çdo rast drejtorët gëzojnë të njëjtën të drejtë të refuzojnë ose të pezullojnë rregjistrimin ashtu siç do të kishin vepruar në rastin e transferimit të një aksioni nga aksioneri përpara vdekjes ose transferimit të tij, sipas rastit.
37. Nëse personi të cilit i kalon titulli mbi mbi aksionin vendos të rregjistrohet vetë, ai duhet t'i dorëzojë ose dërgojë shoqërisë një njoftim me shkrim të nëshkruar nga ai vetë ku ai deklaron zgjedhjen e tij. Nëse ai zgjedh të rregjistrojë një person tjetër, ai duhet të dëshmojë zgjedhjen e tij duke kryer transferimin e aksionit tek personi tjetër. Të gjithë kufizimet, limitimet dhe dispozitat e tjera të këtij statuti mbi të drejtën e transferimit dhe rregjistrimin e aksioneve do të jenë të zbatueshme për çdo njoftim ose transferim të lartpërmendur në të njëjtën mënyrë sikur vdekja apo falimentimi i aksionerit të mos kishte ndodhur dhe njoftimi ose transferimi të ishte nëshkruar nga vetë aksioneri.
38. Personi të cilit i kalon titulli për arsye vdekjeje ose falimentimi të titullarit gëzon të drejtën mbi të njëjtin dividend dhe të gjithë avantazhet e tjera që do të kishtë gëzuar si titullar i rregjisitruar i aksionit, me përjashtim të faktit se ai, përpara se të rregjistrohej si aksioner, kishte të drejtë të ushtronte mbi të të drejta që rridhnin për të nga anëtarësimi (pjesmarrja) i tij në mbledhjet e shoqërisë.

Gjithmonë duke pasur parasysh faktin se drejtorët kanë të drejtë të bëjnë një njoftim ku kërkojnë nga ky aksioner që të zgjedhë midis rregjistrimit të tij dhe transferimit të aksionit, dhe nëse kërkesat që përmban njoftimi nuk janë zbatuar, brenda nëntëdhjetë ditëve, drejtorët kanë të drejtë të pezullojnë shpërndarjen e dividendit, bonuseve ose shumave të tjera të ekzekutueshme në lidhje me aksionin derisa të përmbushen kërkesat e parashikuara në njoftim.

SEKUESTRIMI

39. Nëse një aksioner nuk shlyen vlerën e aksionit pas një thirrjeje për shlyerje ose nuk paguan kështu për shlyerjen në afatin e caktuar për pagesën, drejtorët kanë të drejtë, në çdo periudhë pasardhëse për sa kohë që një pjesë e shumës që duhet shlyer, ose e kështit, mbetet e papaguar, ti dërgojnë një njoftim aksionerit ku kërkojnë pagesën e vlerës së shlyerjes ose të kështit të papaguar, së bashku me interesin që mund të jetë rritur.
40. Njoftimi duhet të parashikojë një datë të mëtejshme (jo më herët se përfundimi i afatit prej katërbëdhjetë ditësh nga data e paraqitjes së njoftimit) në të cilën, ose përpara së cilës, duhet shlyer pagesa e kërkuar në njoftim, dhe duhet të parashikojë se në rastin e mos-ekzekutimit të detyrimit në datën e caktuar, ose përpara datës së caktuar, aksionet mbi vlerën e të cilëve është kërkuar shlyerja do të mund të sekuestrohen.
41. Nëse kërkesat që përmban njoftimi sipas mënyrës së lartpërmendur nuk përmbushen, çdo aksion në lidhje me të cilin është dhënë një njoftim mund, në çdo kohë pas njoftimit dhe përpara se të kryhet pagesa e kërkuar nga njoftimi, të sekuestrohet në bazë të vendimit të drejtorëve për këtë.
42. Një aksion i sekuestruar mund të shitet ose të tjetërsohet sipas kushteve dhe mënyrës që drejtorët konsiderojnë të përshtatshme dhe në çdo kohë përpara shitjes ose tjetërsimit sekuestrimi mund të tërhiqet në baze të kushteve që drejtorët konsiderojnë të përshtatshme.
43. Personit të cilit i janë sekuestruar aksionet pushon së qeni titullar i aksioneve të sekuestruara, por megjithatë ai mbetet përgjegjës për shlyerjen kundrejt shoqërisë e të gjithë shumave, të cilat, në datën e sekuestrimit, ishin të kërkueshme nga shoqëria mbi vlerën e aksioneve, por detyrimi i tij do të shuhet nëse dhe kur ai i paguan shoqërisë të gjithë shumat që ai i detyrohej mbi vlerën e aksioneve.
44. Nje deklaratë e ligjshme me shkrim mbi faktin se deklaruesi është drejtor ose sekretar i shoqërisë dhe se aksioni në kapitalin e shoqërisë është sekuestruar rregullisht në datën e përcaktuar në deklaratë, përbën një provë të mjaftueshme të vërtetimit të fakteve që përmban deklarata kundrejt të gjithë personave që pretendojnë se gëzojnë titull mbi aksionet. Shoqëria ka të drejtë të marrë shpërblimin, nëse ka, për aksionet ose që rrjedh nga shitja ose tjetërsimi i tyre dhe gjithashtu ka të drejtë të kryejë transferimin e aksionit në favor të personit të cilit i është shitur aksioni ose tjetërsuar dhe ky i fundit ka të drejtë të rregjistrohet mbi këtë bazë si titullar i aksionit dhe nuk është i detyruar të ndjekë përdorimin e shumës së blerjes, nëse ka, dhe titulli i tij mbi aksionin nuk do të dëmtohet nga parregullsi ose pavlefshmëri të procedurave të sekuestrimit, shitjes apo tjetërsimit të aksionit.
45. Dispozitat e këtij statuti mbi sekuestrimin zbatohen në rastin e mos-ekzekutimit të çdo shume e cila, sipas kushteve të emetimit të aksioneve, është e kërkueshme në një periudhë të caktuar kohe, qoftë mbi vlerën nominale të aksioneve, qoftë mbi primin, në të

njetën mënyrë sikur e njejta shumë të ishtë e kërkueshme në bazë të thirrjes për shlyerje të kryer dhe të njoftuar rregullisht.

KTHIMI I AKSIONEVE NË OBLIGACIONE


46. Shoqëria ka të drejtë, me anë të një vendimi të asamblesë së zakonshme, të kthejë aksionet e shlyera në obligacione, dhe ti rikthejë obligacionet në aksione të shlyera të çdo lloji.
47. Zotëruesi i obligacioneve mund ti transferojë ato, ose pjesë të tyre, në të njetën mënyrë dhe sipas të njëjtave rregullave që parashikohen për transferimin e aksioneve të cilat janë konvertuar në obligacione ose në mënyrën më të përafërt të mundur; dhe drejtorët kanë të drejtë herë pas here të përcaktojnë numrin minimal të obligacioneve të transferueshme, por me kusht që ky numër të mos tejkalojë numrin nominal të aksioneve nga të cilët rrjedhin obligacionet.
48. Titullarët e obligacioneve gëzojnë, proporcionalisht me numrin e obligacioneve që zotërojnë, të njejtat të drejta, privilegje ose avantazhe në lidhje me dividendin, të drejtat e votës në mbledhjet e shoqërisë dhe çështje të tjera që ata do të gëzonin si titullarë të aksioneve nga të cilët rrjedhin obligacionet, por asnjë numër obligacionesh (me përjashtim të pjesmarrjes në shpërndarjen e dividendit dhe në fitimet e shoqërisë si dhe në asetet e likuidimit) nuk jep të drejta që nuk do të kishin ekzistuar në lidhje me aksionet.
49. Nenet e statutit që janë të zbatueshme për aksionet e shlyera të shoqërisë do të zbatohen edhe për obligacionet, dhe fjalët "aksione" dhe "aksioner" thë përdorura aty do të përfshijnë "obligacione" dhe "obligatere".

NDRYSHIMI I KAPITALIT

50. Herë pas here, me vendim të zakonshëm shoqëria mund të rrisë kapitalin e saj në shumën e përcaktuar në këtë vendim, shumë e cila do të ndahet në aksione.
51. Me vendim të zakonshëm, shoqëria mund:
- (a) të bashkojë apo ndajë të gjitha apo pjesë të kapitalit të saj në aksione apo shuma më të mëdha se aksionet ekzistuese;
 - (b) nëndajë aksionet e saj ekzistuese, apo pjesë të tyre, në aksione me vlerë më të vogël sesa ajo e përcaktuar në aktin e themelimit, dhe pa rënë ndesh me dispozitat e nenit 60 (1) (d) të Ligjit;
 - (c) të anullojë aksione të cilat në datën e marrjes së vendimit nuk janë marrë nga askush.
52. Me vendim të posaçëm, shoqëria mund të zvogëlojë kapitalin e saj, çdo fond rezervë kapitali apo çdo llogari aksioni siç parashikohet dhe rregullohet nga ligji.

ASAMBLETË E PËRGJITHSHME

53. Çdo vit shoqëria do të zhvillojë një mbledhje të asamblesë së përgjithshme si asamble të sajën vjetore përveç mbledhjeve të tjera gjatë atij viti, dhe këtë mbledhje vjetore do t'a specifikojë në njoftimet për thirrjen e saj, dhe nuk do të ketë një hapësirë kohore më të madhe se pesëmbëdhjetë muaj nga një asamble e përgjithshme në tjetrën. Nëse shoqëria



do të zhvillojë mbledhjen e asamblesë së përgjithshme vjetore brenda tetëmbëdhjetë muajve nga themelimi i saj, ajo nuk do të ketë nevojë të mbajë një mbledhje të tillë gjatë vitit të themelimit apo vitit pasardhës. Asambleja e përgjithshme do të mbahet në vendin, ditën dhe orën e caktuar nga drejtorët.

54. Të gjitha asambletë e përgjithshme përveç mbledhjeve të asamblesë së përgjithshme vjetore do të quhen asamble të përgjithshme të jashtëzakonshme.
55. Kurdo që do të konsiderohet e përshtatshme nga drejtorët, ata mund t'a thërrasin mbledhjen e asamblesë së jashtëzakonshme në çdo kohë, dhe në mungesë të një thirrje prej tyre ajo mund të thirret edhe sipas nenit 126 të Ligjit. Nëse në ndonjë moment të caktuar nuk do të ketë drejtorë të mjaftueshëm në Qipro, me qëllim që të arrijnë kuorumin e kërkuar, çdo drejtor apo të paktën dy aksionerë të shoqërisë do të kenë të drejtë të thërrasin një mbledhje të asamblesë së përgjithshme të jashtëzakonshme në pothuaj të njëjtën mënyrë si në rastin kur mbledhja do të thirrej nga drejtorët.

NJOFTIMI PËR ASAMBLETË E PËRGJITHSHME

56. Çdo mbledhje e përgjithshme vjetore dhe çdo mbledhje e thirrur për miratimin e një vendimi të posaçëm do të thirret mbi bazën e një njoftimi me shkrim të dërguar të paktën njëzetën ditë më parë, dhe çdo mbledhje tjetër përveçse sa cituar më lart do të thirret me dërgimin e një lajmërimi me shkrim të dërguar të paktën katërmëdhjetë ditë përpara. Njoftimi do të ketë datën në të cilën ai dërgohet dhe do të specifikojë vendin, ditën dhe orën e mbledhjes, dhe në rastin e një çështje të veçantë, do të përshkruhet edhe natyra e kësaj çështje, dhe do t'u dërgohet atyre personave që sipas dispozitave përkatëse e kanë të drejtën për të marrë një njoftim të tillë nga shoqëria.

Pavarësisht se njoftimi është dërguar brenda një afati më të shkurtër sesa është parashikuar nga dispozitat përkatëse, mbledhja e asamblesë do të konsiderohet se është thirrur rregullisht:

- (a) nëse mbledhja vjetore e përgjithshme është thirrur nga të gjithë aksionerët me të drejtë pjesëmarrje dhe vote; dhe
- (b) në rast se bëhet fjalë për asamble të natyrave të tjera, nëse votohet pro nga shumica në numër e aksionerëve me të drejtë pjesëmarrje dhe vote të cilët përfaqësojnë një shumicë që përfaqëson jo më pak se 95 përqind të vlerës nominale të aksioneve me të drejtë vote.
57. Moskryerja padashje e njoftimit të asamblesë, apo mosmarrja e njoftimit të mbledhjes së asamblesë, nga personi që e ka një të drejtë të tillë, nuk do të përbëjë shkak për pavlefshmërinë e mbledhjes.

PROCEDURA NË ASAMBLETË E PËRGJITHSHME

58. Të gjitha çështjet do të konsiderohen si të posaçme dhe do të shqyrtohen në një asamble të përgjithshme të jashtëzakonshme si dhe në një asamble të përgjithshme vjetore, me përjashtim të vendimeve lidhur me deklarimin e dividendëve, miratimin e llogarive, bilanceve, dhe raporteve të drejtorëve dhe auditorëve, zgjedhjen e drejtorëve në vend të atyre që dalin në pension dhe emërimin dhe caktimin e shpërblimeve për auditorët.
59. Asnjë çështje nuk do të shqyrtohet nga asambleja e përgjithshme nëse nuk është kuorumi i aksionerëve të pranishëm në kohën e asamblesë, përveçse kur parashikohet ndryshe

këtu, dhe përveçse kur një aksioner i pranishëm personalisht apo me prokurë përbën kuorumin.

60. Nëse brenda gjysëm ore nga ora e asamblesë nuk arrihet kuorumi, asambleja do të shpërndahet; në raste të tjera ajo do të shtyhet për në ditën e njëjtë të javës së ardhshme, dhe në të njëjtin orar dhe vend, dhe nëse edhe pas asamblesë së dytë nuk arrihet kuorumi brenda gjysëm ore pas orës së caktuar për mbledhjen e asamblesë, do të konsiderohet se aksionerët e pranishëm përbëjnë kuorumin e duhur.
61. Nëse ka një Kryetar të bordit drejtues, ai do të jetë edhe kryetari i asamblesë së përgjithshme të shoqërisë, dhe nëse nuk ka një kryetar të tillë, ose nëse ai nuk do të paraqitet brenda pesëmbëdhjetë minutave pas orës së caktuar për mbledhjen e asamblesë, atëherë drejtorët do të zgjedhin njërin prej tyre për të qenë kryetari i asamblesë.
62. Nëse në mbledhjen e asamblesë askush nuk dëshiron të kryejë detyrën e kryetarit apo nëse asnjë prej drejtorëve nuk paraqitet brenda pesëmbëdhjetë minutave pas kohës së caktuar për mbledhjen e asamblesë, aksionerët e pranishëm do të zgjedhin njërin prej tyre si kryetar të asamblesë.
63. Me miratimin e asamblesë në të cilën është arritur kuorumi i kërkuar, kryetari mund të shtyjë zhvillimin e asamblesë, herë pas here, dhe në çdo vend, por asnjë çështje nuk do të kalojë për shqyrtim në asamblenë e ardhshme të shtyrë përveçse atyre çështjeve që janë lënë të papërfunduara dhe për të cilin u krye shtyerja e asamblesë. Nëse shtyhet një mbledhje asambleje për tridhjetë ditë apo më shumë, njoftimi për asamblenë e shtyrë do të dërgohet sikur të bëhej fjalë për njoftim për herë të parë. Përveç sa parashikohet më sipër, nuk do të jetë e nevojshme që të jipet një njoftim për çështjet e shtyra për në një asamble tjetër.
64. Në çdo asamble të përgjithshme, çdo vendim i hedhur në votë në këtë asamble do të merret me ngritje dore, përveçse kur kërkohet një votim i fshehtë:
- (a) nga kryetari; ose
 - (b) nga të paktën dy aksionerë të pranishëm personalisht apo me prokurë; ose
 - (c) nga çdo aksioner i pranishëm personalisht apo me prokurë dhe që përfaqëson jo më pak se një të dhjetën e votave të të gjithë aksionerëve me të drejtë vote në asamble; ose
 - (d) nga një aksioner që ka aksione në shoqërinë që delegon një të drejtë vote, aksionet e të cilit që janë shlyer nuk kanë një vlerë më të vogël se një e dhjeta e shumës së paguar për të gjitha aksionet që japin një të drejtë vote.
- Nëse nuk kërkohet votim, deklarimi nga kryetari se është marrë vendimi me ngritje dore në mënyrë unanime, apo me një shumicë të caktuar, apo se nuk është aprovuar, dhe ky vendim regjistrohet në procesverbalet e shoqërisë, atëherë ai do të ketë fuqi të plota dhe do të jetë provë e faktit të konstatuar pa qenë nevoja për të cituar sa persona votuan pro e sa kundër.
- Kërkesa për votim mund të tërhiqet.
65. Përveçsa parashikohet në nenin 69, nëse kërkohet votim, ai do të kryhet në mënyrën që e kërkon kryetari, dhe rezultati i këtij votimi do të konsiderohet se është vendimi i asamblesë në të cilën u kërkua votim.

66. Në rast barazie votash, me ngritje dore apo me votim, vota e kryetarit të asamblesë nuk do të jetë votë mbizotëruese.
67. Kur kërkohet një votim për zgjedhjen e kryetarit apo për të shtyrë një çështje, ky votim do të kryhet menjëherë. Kur kërkohet votim për çështje të tjera ai do të merret në atë kohë siç do të vendoset nga kryetari, dhe do të trajtohet çdo çështje përveç asaj për të cilën u kërkua votim.

VOTAT E AKSIONERËVE

68. Duke respektuar çdo të drejtë apo kufizim që lidhet me ndonjë tip aksioni, çdo aksioner i pranishëm personalisht do të ketë vetëm një votë, dhe në votim çdo aksioner do të ketë vetëm një votë për çdo aksion të zotëruar prej tij.
69. Në rast zotërimi të përbashkët të aksionit nga disa persona, vota e personit më të vjetër si aksionar, e dhënë personalisht apo me prokurë, do të jetë e vetmja që do të pranohet duke përjashtuar votat e bashkëzotëruesve të tjerë; për këtë qëllim vjetërsia do të përcaktohet nga renditja e emrave në regjistër.
70. Një aksioner pa gjendje mendore të shëndoshë, apo ndaj të cilit është marrë një vendim gjyqësor për çmenduri, mund të votojë me anë të administratorit të pasurisë, të komitetit, kujdestarit të tij apo nga kushdo tjetër në cilësinë e administratorit, komitetit apo kujdestarit të caktuar nga Gjykata dhe secili nga këto persona mund të votojë mbi bazë prokure.
71. Askush nuk do të ketë të drejtë të votojë në mbledhjen e përgjithshme të asamblesë nëse personi nuk ka paguar të gjitha shumatat që i detyrohet shoqërisë.
72. Nuk do të paraqitet asnjë kundërshtim për cilësinë e ndonjë votuesi përveçse në asambletë në të cilat është paraqitur kundërshtimi dhe çdo votë e pakundërshtuar në këtë asamble do të jetë e vlefshme. Çdo kundërshtim i tillë i kryer në kohën e duhur do t'i komunikohet kryetarit të asamblesë vendimi i të cilit do të jetë përfundimtar.
73. Votat mund të jipen ose personalisht ose me prokurë.
74. Prokura do të jetë me shkrim dore apo do të vërtetohet nga avokati me shkrim, apo nëse përfaqësuesi është shoqëri, prokura do të jetë ose e vulosur apo e vërtetuar nga një zyrtar apo avokat. Një aksioner i shoqërisë nuk ka nevojë për prokurë.
75. Prokura apo çdo dokument tjetër, e cila mban vërtetimin e noterit, do të depozitohet në selinë e shoqërisë apo në çdo vend tjetër në Qipro siç do të përcaktohet për këtë qëllim në thirrjen e asamblesë, në çdo kohë para zhvillimit të asamblesë, në të cilën personi përkatës autorizohet të votojë, përndryshe prokura nuk do të konsiderohet e vlefshme.
76. Prokura do të jetë në formën e mëposhtme:
(Emri i shoqërisë)
Unë/Ne
në cilësinë e aksionerit/aksionerëve të shoqërisë së mësipërme, nëpërmjet këtij akti caktoj/më me prokurë _____ që _____ të më/na përfaqësojë në asamblenë e (zakonshme apo të jashtëzakonshme) të shoqërisë, e cila do të mbahet më _____ dhe asambleja shtyrëse më datë _____.

77. Kur adresohet me qëllim që aksionerët të votojnë pro apo kundër një vendimi prokura do të jetë në formën vijuese:

(Emri i shoqërisë)

Unë/Ne

në cilësinë e aksionerit/aksionerëve të shoqërisë së mësipërme, nëpërmjet këtij akti caktoj/më me prokurë _____ që _____ të më/na përfaqësojë në asamblenë e (zakonshme apo të jashtëzakonshme) të shoqërisë, e cila do të mbahet më _____ dhe asambleja shtyrëse më datë _____.

Kjo formë do të përdoret për një votim pro/kundër ndaj vendimit. Nëse nuk udhëzohet ndryshe, personi i autorizuar do të votojë sipas gjykimit të tij.

78. Prokura do të konsiderohet se delegon të drejtën për të kërkuar votim.

79. Vota e dhënë në përputhje me kushtet e prokurës do të jetë e vlefshme pavarësisht vdekjes së parakohshme apo sëmundjes mendore të të përfaqësuarit apo revokimit të prokurës apo autoritetit lëshues, me kusht që asnjë njoftim për këtë vdekje, sëmundje mendore, revokim apo transferim nuk i është njoftuar më parë në selinë e saj shoqërisë, para fillimit të asamblesë për të cilën është lëshuar prokurë.

80. Në përputhje me dispozitat e Ligjit, vendimi me shkrim i nënshkruar nga të gjithë aksionerët që kanë të drejtë për t'u njoftuar dhe për të marrë pjesë dhe votuar në asamblenë e përgjithshme do të jetë po aq e vlefshme sa sikur të ishte marrë nga asambleja e përgjithshme e shoqërisë e thirrur dhe e mbajtur në mënyrë të rregullt. Çdo vendim i tillë mund të jetë i përbërë nga disa dokumenta, nënshkruar nga një apo disa nga aksionerët apo avokatët e tyre, dhe në rast se njëri prej aksionerëve është shoqëri, nënshkrimi i bërë do të jetë i mjaftueshëm nëse është hedhur nga një Drejtor apo nga zyrtari i autorizuar për këtë qëllim apo avokati i emëruar.

SHOQËRI QË VEPROJNË NË ASAMBLE MBI BAZËN E PËRFAQËSIMIT

81. Çdo shoqëri që është aksionere e shoqërisë, me vendim të drejtorëve të saj apo organeve të tjera, mund të autorizojë atë person që ajo e gjykon si të përshtatshëm me qëllim që t'a përfaqësojë atë në asamblenë e shoqërisë apo si çdo lloj aksioneri të shoqërisë, dhe personi i autorizuar në këtë mënyrë do të ketë të gjitha të drejtat në emër të shoqërisë të përfaqësuar ashtu sikur kjo shoqëri të ishte një individ aksioner i shoqërisë.

DREJTORËT

82. Përderisa nuk vendoset ndryshe nga asambleja e përgjithshme e shoqërisë, numri i drejtorëve nuk do të jetë më pak se dy dhe nuk do të ketë fufij maksimalë. Drejtorët e parë të shoqërisë do të caktohen me shkrim nga nënshkruesit e aktit të themelimit apo nga shumica e tyre dhe për pasojë nuk do të jetë nevoja që të mbahet ndonjë asamble për këtë qëllim.

83. Shpërblimi i drejtorëve do të përcaktohet nga asambleja e përgjithshme e shoqërisë. Ky shpërblim do të akumulohet çdo ditë. Drejtorët mund tju paguhen gjithashtu të gjitha shpenzimet e udhëtimeve, hotelit dhe shpenzime të tjera të kryera prej tyre për shkak të marrjes pjesë në mbledhjen e drejtorëve të shoqërisë apo të komiteteve të drejtorëve apo të asambleve të përgjithshme të shoqërisë apo ato që lidhen me aktivitetin e shoqërisë.

84. Shkalla e pjesëmarrjes në aksione të drejtorëve do të caktohet nga asambleja e përgjithshme e shoqërisë, dhe nëse nuk ka ndonjë vendim të tillë nuk do të aplikohet ndonje shkallë pjesëmarrje.
85. Çdo drejtor i shoqërisë mund të jetë apo bëhet drejtor apo zyrtar në ndonjë shoqëri tjetër të promovuar nga shoqëria apo në të cilën shoqëria në fjalë ka interesa si aksioner, dhe shoqëria nuk do t'i njohë atij asnjë shpërblim apo përfitim tjetër të marrë prej tij si drejtor në këtë shoqëri tjetër, përveçse kur parashikohet ndryshe nga shoqëria.

TË DREJTAT PËR TË MARRË HUA

86. Drejtorët mund të ushtrojnë të gjitha kompetencat e shoqërisë me qëllim marrjen e huave, si dhe ato që lidhen me ngarkimin me barrë apo vënien hipotekë mbi sipërmarrjen, pasurinë dhe kapitalin e saj, apo pjesë të tyre, si dhe për të dhënë garanci të tjera për çdo borxh apo detyrim të shoqërisë.

TË DREJTAT DHE DETYRAT E DREJTORËVE

87. Aktiviteti i shoqërisë do të menaxhohet nga drejtorët, të cilët mund të paguajnë të gjitha shpenzimet në lidhje me formimin dhe regjistrimin e shoqërisë, dhe mund të ushtrojnë të gjitha kompetencat të cilat nuk i janë rezervuar me Ligj apo këtë statut për asambleenë e përgjithshme të shoqërisë, detyrë që duhet t'a kryejnë në përputhje me dispozitat ligjore dhe statute, dhe jo në kundërshtim me sa më sipër si dhe siç do të parashikohet nga asambleja e përgjithshme. Gjithashtu asnjë vendim i marrë në asambleenë e përgjithshme nuk do të çvlerësojë aktet e mëparshme të drejtorëve të cilat do të ishin të vlefshme nëse nuk do të ishte miratuar ndryshimi në statut.
88. Në çdo kohë dhe mbi bazën e një prokure të posaçme, drejtorët mund të caktojnë një shoqëri, firmë apo person, të emëruar direkt apo indirekt nga drejtorët, që të jetë avokati i shoqërisë për qëllimet dhe fushat, autorizimet (pa kaluar ato të cilat kanë drejtorët sipas këtij statuti) dhe për atë afat dhe sipas atyre kushteve që do të gjykohen të arsyeshme nga drejtorët, dhe kjo prokurë mund të përmbajë ato dispozita për mbrojtjen e personave që merren me këta avokatë, siç do të gjykohet nga drejtorët, të cilët mund të autorizojnë avokatët që të delegojnë tërësisht apo pjesërisht kompetencat dhe autorizimet e tyre.
89. Shoqëria mund të ushtrojë të drejtat e caktuara në nenin 36 të Ligjit në lidhje me patjen e një vule për t'u përdorur jashtë vendit dhe kjo e drejtë do t'u jipet drejtorëve.
90. Shoqëria mund të ushtrojë kompetencat e dhëna nga shoqëria sipas neneve 114 deri 117 (duke i përfshirë të dyja) të Ligjit në lidhje me mbajtjen e një regjistri, dhe drejtorët (në bazë të dispozitave të këtyre neneve) mund t'i ndryshojnë këto dispozita siç do të gjykohet e arsyeshme prej tyre, duke respektuar mbajtjen e këtij regjistri.
- 91.
- (1) Ndonjë drejtor i cili direkt apo indirekt ka interes në ndonjë kontratë apo projekt kontratë me shoqërinë do të deklarojë natyrën e interesit të tij në mbledhjen e drejtorëve sipas nenit 191 të Ligjit.
 - (2) Çdo drejtor mund të votojë në lidhje me kontratën apo projekt kontratën pavarësisht se ai mund të ketë ndonjë interes në të dhe nëse ai vepron kështu vota e tij do të numërohet dhe

ai mund të konsiderohet pjesë e kuorumit të çdo asamble të drejtorëve në të cilën kjo kontratë apo projekt kontratë do të shqyrtohet.

- (3) Drejtori mund të ketë çdo detyrë apo përfitim tjetër në shoqëri (përveç detyrës së auditorit) pavarësisht detyrës së tij si drejtor dhe kjo situatë mund të vazhdojë për aq kohë dhe me ato kushte (sipas shpërblimit) siç do të vendoset nga drejtorët dhe asnjë drejtor nuk do të përjashtohet nga detyra e tij për shkak të kontraktimit me shoqërinë për shkak të mbajtjes së detyrës apo përfitimit tjetër të tij si shitës, blerës apo palë të ngjashme. Asnjë nga kontratat e lidhura nga dhe në emër të shoqërisë, me të cilat ndonjë drejtor ka interes, nuk do të shfuqizohen, dhe në të njëjtën kohë asnjë drejtor kontraktues nuk do të jetë përgjegjës ndaj shoqërisë për ndonjë përfitim të realizuar me këtë kontratë apo për shkak se ky drejtor ka patur atë detyrë të besuar.
 - (4) Çdo drejtor mund të veprojë veçmas dhe ai do të ketë të drejtën e një shpërblimi për shërbimet profesionale sikur të mos ishte drejtor me kusht që asnjë dispozitë e parashikuar këtu nuk do të autorizojë ndonjë drejtor që të veprojë si auditor i shoqërisë.
92. Të gjitha çeqet, premtim pagesat, kambialet dhe çdo instrument tjetër financiar, dhe të gjitha arkëtimet e parave të paguara për shoqërinë, do të nënshkruhen, tërhiqen, pranohen apo ekzekutohen, siç mund të jetë rasti, në atë mënyrë që do të vendoset nga drejtorët.
93. Drejtorët do të mbajnë në procesverbale-libra të posaçëm:
- (a) të gjitha takimet e zyrtarëve me drejtorat;
 - (b) të gjitha emrat e drejtorëve të pranishëm në çdo mbledhje të drejtorëve dhe mbledhje të komiteteve të drejtorëve;
 - (c) të gjitha vendimet dhe veprimet e kryera në mbledhjet e shoqërisë dhe në ato të drejtorëve, si dhe komitetit të drejtorëve.

PENSIONET

94. Drejtorët mund të japin pensione pleqërie apo vjetore apo shpërblime të tjera, duke përfshirë edhe ato për raste vdekjeje, për çdo person për shërbimet e ofruara nga ai në favor të shoqërisë si drejtor ekzekutiv apo në çfarëdo lloj detyre në shoqëri, apo në mënyrë indirekte si zyrtar, punonjës i ndonjë dege, filiali apo shoqërie të lidhur, pavarësisht nëse ai është apo ka qenë drejtor në shoqëri, dhe në të njëjtën kohë shoqëria mund të kryejë pagesa për skema sigurimesh apo fonde që lidhen me këta persona, të cilat mund të përfshijnë të drejta që lidhen me pensionet dhe shpërblimet për angazhimin me punë apo shërbime të ofruar nga këta persona.

HUMBJA E CILËSISË SI DREJTOR

95. Detyra si drejtor do të mbarojë nëse drejtori:
- (a) nuk mund të jetë më drejtor sipas nenit 176 të Ligjit; apo
 - (b) falimenton apo arrin ndonjë marrëveshje me kreditorët në përgjithësi; apo
 - (c) ndalohet të ushtrojë detyrën si drejtor për shkak të ndonjë urdhri të parashikuar në nenin 180 të Ligjit; apo

- (d) sëmuret mendërisht; apo
- (e) heq dorë nga detyra e tij me shkrim.

EMËRIMI I DREJTORËVE TË TJERË SIDHE SHKARKIMI I TYRE

96. Herë pas here, drejtorët do të kenë të drejtë të emërojnë çdo person si drejtor, si për të zënë ndonjë vend vakant apo si shtesë të drejtorëve ekzistues, por që numri total i drejtorëve të mos kalojë numrin e caktuar me rregullore. Çdo drejtor i emëruar do të qëndrojë në detyrë deri në asamblenë e përgjithshme të ardhshme dhe do të ketë të drejtën për t'u rizgjedhur.
97. Me vendim të zakonshëm, lajmërimi i së cilës është bërë në përputhje me neni 136 të Ligjit, shoqëria mund të heqë çdo drejtor përpara mbarimit të afatit të detyrës së tij pavarësisht nga sa prashikohet këtu apo me marrëveshje me të. Ky shkarkim nuk do të bie ndesh me asnjë pretendim të drejtorit në fjalë i cili mund t'a ketë atë për dëmet apo shkeljet e kontratës apo shërbimit midis tij dhe shoqërisë.
98. Në çdo kohë, shoqëria (pa rënë ndesh me kompetencat e drejtorëve sipas nenit 96) me vendim të zakonshëm mund të caktojë një drejtor sidhe periudhën gjatë së cilës ai do të qëndrojë në detyrë.

PROCEDURA NË MBLEDHJET E DREJTORËVE

99. Drejtorët mund të takohen sëbashku për qëllime të aktivitetit si dhe t'i caktojnë këto asamble siç do të gjykohet e përshtatshme prej tyre për çështjet e këtyre asambleve, dhe vendimet në këto asamble do të merren me shumicë votash. Drejtori, si dhe sekretarja e emëruar duhet të hartojnë një njoftim të asamblesë. Është e nevojshme që të njoftohen 96 orë përpara drejtorët që janë jashtë Qipros dhe të cilët kanë dhënë një adresë që ndodhet jashtë Qipros. Të gjitha mbledhjet e bordit dhe të komitetit do të zhvillohen në Qipro, ku do të jetë dhe organi drejtues dhe kontrollues i shoqërisë.
100. Kuorumi i nevojshëm për aktivitetin e drejtorëve mund të caktohet prej tyre, dhe nëse nuk veprohet kështu do të jenë dy drejtorë apo zëvendësuesit e tyre.
101. Drejtorët do të vazhdojnë të kryejnë funksionet e tyre pavarësisht ndonjë vendi vakant, por nëse numri i tyre zbret nën numrin e caktuar apo siç parashikohet nga rregullorja e shoqërisë si kuorumi i nevojshëm, këta drejtorë mund të veprojnë me qëllim që të rrisin numrin e drejtorëve në atë numër të nevojshëm me qëllim thirjen e asamblesë së shoqërisë dhe vetëm për këtë të fundit.
102. Drejtorët mund të zgjedhin një kryetar të mbledhjes së tyre si dhe të përcaktojnë periudhën për të cilën ai do të qëndrojë si i tillë; por nëse nuk zgjidhet ndonjë kryetar, apo nëse kryetari nuk është i pranishëm në asamble pesë minuta pas orarit të caktuar për asamble, drejtorët e pranishëm mund të zgjedhin njërin prej drejtorëve të pranishëm me qëllim që të kryesojë asamblenë.
103. Drejtorët mund t'ia delegojnë kompetencat e tyre një apo disa komiteteve të përbërë me aq persona sa do të gjykohet e arsyeshme prej tyre; çdo komitet i formuar në këtë mënyrë për ushtrimin e kompetencave të deleguara sipas rregullores mund t'i nënshtrohet kompetencave, procedimeve dhe kuorumeve të caktuara nga drejtorët.

104. Komiteti mund të caktojë një kryetar për mbledhjen e tij; nëse nuk është zgjedhur ndonjë kryetar, apo kryetari nuk është i pranishëm në mbledhje pesë minuta pas orarit të caktuar për asamble, aksionerët e pranishëm mund të zgjedhin njërin prej aksionerëve të pranishëm me qëllim që të kryesojë mbledhjen.
105. Në përputhje me rregullat e vendosura nga drejtorët, komiteti mund të mblidhet kur e gjykon të arsyeshme dhe çështjet e shtruar në këto mbledhje do të gjidhen me vendim të shumicës së aksionerëve të pranishëm.
106. Të gjitha veprimet e ndërmarra nga drejtorët apo komiteti i drejtorëve apo nga ndokush i cili vepron si drejtor, pavarësisht nga fakti nëse ai nuk është zgjedhur sipas rregullave apo fakti se ai është skualifikuar, do të jenë po aq të vlefshme sikur të kishin qenë persona të zgjedhur në mënyrë të duhur.
107. Vendimi me shkrim i nënshkruar apo miratuar me letër, teleks, faks apo telegram nga drejtorët apo zëvendësuesit e tyre do të jetë po aq i vlefshëm sa vendimi i marrë në asamblenë e drejtorëve të thirrur e të mbajtur.

DREJTORËT ZËVENDËSUES

- 108.
- (a) Çdo drejtor ka të drejtë të caktojë herë pas here ndonjë drejtor apo person tjetër, jo drejtor, si drejtor zëvendësues të tyre, si dhe t'i shkarkojnë ata si të tillë.
 - (b) Drejtori zëvendësues (përveç pushtetit për të caktuar një drejtor zëvendësues dhe shpërblimin) do t'i përmbahet kushteve që lidhen me drejtorët e tjerë si dhe do të ketë të drejtë të marrë njoftimet e të gjitha mbledhjeve të drejtorëve, të marrë pjesë, marrë fjalën dhe votojë në to, kur personi që e ka zgjedhur nuk mund të marrë pjesë në to.
 - (c) Një person mund të veprojë si zëvendësues drejtor për një apo disa drejtorë dhe si i tillë do të ketë të drejtë të veçantë vote për çdo drejtor që ai përfaqëson, dhe nëse ai vet është drejtor, vota/t e tij si drejtor zëvendësues do t'i shtohen votës së tij.
 - (d) Çdo emërim apo shkarkim i një drejtori zëvendësues mund të bëhet me telefon, telegram apo radiogram si dhe me çdo mënyrë tjetër të miratuar nga drejtorët. Çdo telefonatë, telegram apo radiogram do të konfirmohet menjëherë me letër.
 - (e) Nëse ndonjë prej drejtorëve bën ndonjë emërim si më sipër do të lerë detyrën e tij si drejtor në një asamble të shoqërisë në të cilën ai është rizgjedhur, personi i caktuar prej tij nuk do të ketë me të drejtën për të vepruar si drejtor zëvendësues.
 - (f) Drejtori nuk do të jetë përgjegjës për veprimet dhe mosveprimet e drejtorit zëvendësues të caktuar prej tij.
 - (g) Drejtori zëvendësues nuk do të merret parasysh në përcaktimin e maksimumit apo minimumit të drejtorëve, por ai do të numërohet për qëllim të kuorumit për çdo mbledhje të drejtorëve në të cilën ai merr pjesë, dhe në të cilën ai do të ketë të drejtë vote.

DREJTORI EKZEKUTIV

109. Herë pas here drejtorët mund të caktojnë një person nga organi i tyre si drejtori ekzekutiv për aq kohë dhe me atë kushte siç do të konsiderohen të përshtatshme nga drejtorët, dhe siç do të bihet dakort në marrëveshjen që do të lidhet për këtë qëllim. Drejtorët do të kenë edhe të drejtën e shkarkimit të tij. Drejtori i zgjedhur në këtë mënyrë, gjatë detyrës së tij, nuk do të dalë në pension, por funksioni i tij do të marrë fund automatikisht sapo t'i mbarojë detyra e tij si drejtor.
110. Drejtori ekzekutiv do të marrë një shpërblim (ose so pagë, komision apo pjesëmarrje në fitime) siç do të gjykohet nga drejtorët.
111. Drejtorët mund t'i besojnë drejtorit ekzekutiv çdo të drejtë që ata e ushtrojnë mbi bazën e atyre kushteve dhe kufizimeve siç do të gjykohet prej tyre, si dhe herë pas here mund t'i revokojnë, tërheqin, ndryshojnë të gjitha apo pjesë të këtyre kompetencave.

SEKRETARI

112. Sekretari do të emërohet nga drejtorët për aq kohë dhe me atë shpërblim dhe me ato kushte që do të konsiderohen të përshtatshme nga po këta drejtorë; çdo sekretar i emëruar prej tyre do të shkarkohet po prej tyre.
113. Askush nuk do të emërohet sekretare nëse është:
- (a) drejtor i vetëm i shoqërisë;
 - (b) një shoqëri, drejtori i vetëm i të cilit është drejtor i vetëm i shoqërisë; apo
 - (c) drejtori i vetëm i një shoqërie i cili është drejtor i vetëm i shoqërisë.
 - (d) Nuk do të kemi të bëjmë me një dokument të saktë nëse kur kërkohet nga ligji dokumenti nuk firmoset si nga drejtori ashtu edhe nga sekretari.

VULA

115. Drejtorët do të marrin masa për ruajtjen e vulës, e cila do të përdoret vetëm nga drejtorët apo nga komiteti i drejtorëve autorizuar nga drejtorët, dhe çdo dokument mbi të cilin do të vihet vula do të nënshkruhet nga një drejtor dhe kundërfirmosur nga sekretarja apo nga një drejtor i dytë apo nga dokush tjetër i emëruar nga drejtorët për këtë qëllim.

DIVIDENTËT DHE REZERVAT


116. Në asamblenë e përgjithshme të saj, shoqëria mund të deklarojë dividendët, por asnjë dividend nuk do të kalojë shumën e rekomanduar nga drejtorët.
117. Herë pas here, drejtorët mund t'i paguajnë aksionerëve dividendë të përkohshëm, siç do të gjykohet e përshtatshme nga drejtorët të cilët do të kenë parasysh fitimet e shoqërisë.
118. Nuk do të paguhet asnjë dividend nëse nuk ka fitim.
119. Përpara se të rekomandojnë ndonjë fitim, drejtorët mund të lenë mënjane nga fitimet e shoqërisë ato shuma që ata mund t'i konsiderojnë si të përshtatshme në formën e rezervave, të cilat në bazë të vendimit të drejtorëve do të përdoren për çdo qëllim për të cilin përdoren fitimet e shoqërisë, si investime në aktivitete (përveç aksioneve) dhe siç do

të konsiderohet e përshtatshme nga drejtorët. Pa i kaluar tek rezervat, drejtorët mund të vendosin t'i mbartin fitimet për vitet e ardhshme duke mos i shpërndarë ato.

120. Përveçse kur ka raste në të cilat persona të caktuar kanë të drejta të posaçme për dividendë mbi aksionet, të gjithë dividendët do të deklarohen dhe paguhen sipas shumave të paguara apo të kredituara për aksionet, por asnjë shumë e paguar apo kredituar për aksionet nuk do të konsiderohet, për qëllime të këtij rregulli, si i paguar për aksionet. Të gjithë dividendët do të paguhen proporcionalisht me shumën e paguara apo të kredituara për aksionet gjatë çdo periudhe; por nëse ka ndonjë aksionet të emetuar me kushte të cilat parashikojnë se ai do të ketë të drejtë për dividendë nga një datë e caktuar, kjo gjë do të zbatohet.
121. Drejtorët mund të zbresin nga çdo dividend i pagueshëm për secilin prej aksionerëve të gjitha shumën (nëse ka ndonjë) që duhet të paguhet prej tij për shoqërinë.
122. Çdo asamble e përgjithshme e shoqërisë që deklaron një dividend apo bonus mund të vendosë se pagimi i këtij dividenti apo bonusi do të bëhet pjesërisht apo totalisht me anë të shpërndarjes së asetëve të caktuara, siç do të konsiderohet e arsyeshme nga drejtorët, dhe këta të fundit do t'i zbatojnë vendimet përkatëse, dhe nëse ka ndonjë vështirësi me shpërndarjen e tyre, siç do të gjykohet e arsyeshme prej drejtorëve, këta mund të lëshojnë çertifikata të fraksionuara dhe mund të caktojnë shumën për shpërndarje për ato asetet specifike apo pjesë të tyre si dhe mund të përcaktojnë pagimin e me cash në favor të aksionerëve sapo të caktohen vlerat me qëllim që të stabilizohen të drejtat e të gjithëve.
123. Çdo dividend, interes apo shumë tjetër e pagueshme në cash për aksionet mund të paguhet me çek apo garanci, i cili do të dërgohet me postë në selinë e titullarit, apo në rast bashkëzotëruesish, në selinë e njërit prej bashkëzotëruesve i cili është i regjistruar i pari në regjistrin e aksionerëve apo atij personi dhe në atë adresë që do të tregohet me shkrim nga titullari apo bashkëzotëruesi i aksionit. Secili prej çeqeve apo garancive do t'i paguhet personit të cilit i drejtohet. Secili prej bashkëzotëruesve mund të lëshojë mandat për marrjen e çdo dividenti, bonusi apo shumave të tjera që lidhen me aksionet e zotëruara prej tyre.
124. Nuk do të aplikohen interesat mbi dividendët e shoqërisë.

LLOGARITË

125. Drejtorët do të marrin masat e duhura me qëllim që të mbahen siç duhet llogaritë në lidhje me:
- (a) të gjitha shumën e mara dhe të shpenzuara nga shoqëria dhe arsyet e këtyre të ardhurave dhe shpenzimeve;
 - (b) të gjitha shitjet dhe blerjet e të mirave të shoqërisë; dhe
 - (c) kreditë dhe detyrimet e shoqërisë.
126. Nuk do të konsiderohet se janë mbajtur librat nëse ato nuk janë mbajtur në atë mënyrë që mund të japin përshtypjen e librave me të dhëna të sakta dhe të ndershme, të cilat lidhen me shpjegimin e transaksioneve dhe çështjet e shoqërisë.

- 
127. Librat e kontabilitetit do të mbahen në selinë e shoqërisë, apo në përputhje me nenin 141 (3) të Ligjit, në vende të tjera siç do të konsiderohet e përshtatshme nga drejtorët, dhe ato do të jenë të hapura për inspektim nga drejtorët.
128. Herë pas here drejtorët do të përcaktojnë nëse dhe në çfarë mase dhe në çfarë momenti dhe vendi dhe mbi bazë të cilave kushteve do të jenë llogaritë e shoqërisë të hapura për inspektim nga aksionerët që nuk janë drejtorë dhe nga jo-aksionerët (të cilët nuk janë drejtorë) të cilët kanë të drejtën e inspektimit të të gjitha apo pjesë të llogarive apo librave kontabël të shoqërisë, përveç kur parashikohet ndryshe në statut apo autorizohet nga drejtorët apo nga asambleja e përgjithshme e shoqërisë.
129. Herë pas here dhe në përputhje me neni 142, 144 dhe 151 të Ligjit, drejtorët do të përgatisin dhe do t'i paraqesin asamblesë së përgjithshme të shoqërisë llogaritë e humbjeve dhe fitimeve, bilancin dhe raportet siç parashikohen në këto nene.
130. Një kopje e bilancit (duke përfshirë çdo dokument të kërkuar nga ligji) i cili do t'i paraqitete asamblesë së përgjithshme të shoqërisë, bashkë me një kopje të raportit të auditorëve do t'i dërgohet secilit prej aksionerëve jo më vonë se njëzetë ditë përpara datës së asamblesë, si edhe çdo personi të regjistruar sipas nenit 31. Nëse nuk parashikohet ndryshe nga statuti, një kopje e këtyre dokumentave nuk do t'i çohet personave që nuk i kanë bërë shoqërisë të ditur adresat e tyre ose më shumë së një prej atyre personave që janë bashkëzotërues të aksioneve.

KAPITALIZIMI I FITIMEVE

130. Në asamblenë e përgjithshme të saj, shoqëria, mbi bazën e rekomandimit të drejtorëve, mund të vendosë mbi kapitalizimin e disa pjesëve të kredisë së evidentuar në llogaritë rezervë të shoqërisë apo të fitimit apo të caktuara për t'u shpërndarë si dividend, edhe nëse kjo shumë është vendosur për t'u shpërndarë, shumë e cila do të shpërndahet ndërmjet aksionerëve që e gëzojnë këtë të drejtë, në përputhje me zotërimet e tyre, me kusht që kjo shumë të mos paguhet me cash por duke shlyer ato shuma të papaguara që lidhen me aksionet e mbajtura respektivisht nga aksionerët apo duke shlyer aksionet e paemetuara, dhe drejtorët do t'i japin fuqi këtij vendimi, me kusht që një llogari premio dhe një rezervë kapitali, vetëm për qëllimet e kësaj norme, të zbatohet për pagimin e aksioneve të paemetuara të cilat do t'i emetohen aksionerëve të shoqërisë si aksione bonuse plotësisht të shlyera.
131. Nëse do të merret një vendim i tillë, drejtorët do të marrin të gjitha masat për të kapitalizuar fitimin e pashpërndarë, dhe do të ndërmarrin të gjitha veprimet për t'a ekzekutuar atë, dhe drejtorët do të kenë të gjitha kompetencat për të lëshuar certifikata të fraksionuara ose pagesa në cash apo siç do të konsiderohet e përshtatshme prej tyre, me qëllim që aksionet të bëhen të shpërndashme me fraksione si dhe do të kenë të drejtë të autorizojnë persona që të lidhin marrëveshje, në emër të aksionerëve, me shoqëri të ndryshme, të cilat mund të kenë të drejtë për kapitalizim, apo (sic mund të jetë rasti) me qëllim pagimin e shoqërisë në emër të tyre, në proporcion me fitimet e tyre që do të kapitalizohen, si dhe pagimin e shumave që mbeten të papaguara dhe që lidhen me aksionet ekzistuese, si dhe çdo marrëveshje e lidhur për këtë qëllim do të jetë detyruese për të gjithë aksionerët.

AUDITIMI

Auditorët do të caktohen dhe detyrat e tyre do të rregullohen në bazë të neneve nga 153 deri në 156 (përfshirë të dyja) të Ligjit.

NJOFTIMET

133. Njoftimet e shoqërisë mund t'i dërgohen aksionerëve të saj ose personalisht ose me postë tek adresa apo (nëse nuk ka adresë, në Qipro) në adresën, nëse ka, në Qipro, të cilën ia ka dhënë shoqërisë për dhënie njoftimesh. Nëse njoftimi dërgohet me postë, njoftimi do të konsiderohet se është kryer plotësisht, dhe se ai është kryer 24 orë pas postimit të tij, dhe në çdo rast, në kohën e zakonshme që kërkohet për të postuar dhe dorëzuar letrën.
134. Njoftimi mund të kryhet nga shoqëria aksionerëve të përbashkët të ndonjë aksioni duke i njoftuar ata nëpërmjet lajmërimit të aksionerit të shkruar i pari në regjistrin e aksionerëve.
135. Njoftimi mund të dërgohet nga shoqëria për personat që kanë të drejtën e aksioneve pas vdekjes apo falimentimit të ndonjë prej aksionerëve duke e dërguar njoftimin për ta me letër të parapaguar, apo adresuar përfaqësuesve të të ndjerit apo kujdestarit të të falimentuarit, apo me çfarëdolloj titulli, tek adresa, nëse ka, e dhënë brenda Qipros për personat që pretendojnë këto të drejta, apo derisa të jipet kjo adresë, duke e dhënë njoftimin në mënyrën që ajo do të jipej nëse vdekja apo falimentimi nuk do të kishte ndodhur.
136. Njoftimet për çdo asamble të përgjithshme do t'i jipen si më sipër:
- (a) të gjithë aksionerëve përveç atyre aksionerëve (që nuk kanë asnjë adresë në Qipro) të cilët nuk i kanë dhënë shoqërisë ndonjë adresë në Qipro për njoftimet;
 - (b) çdo personi i cili përfaqëson pronësinë e ndonjë aksioni të zotëruar nga ndonjë person juridik apo person i besuar, për shkak të së drejtës së personit për të marrë njoftim por fakt i cili nuk është vërtetuar për shak të falimentimit apo vdekjes së tij; dhe
 - (c) auditorit të shoqërisë.
Askush tjetër nuk do të ketë të drejtë të marrë njoftim.

NDARJA

137. Nëse shoqëria do të ndahet, likuidatori, me konfirmim të asamblesë së jashtëzakonshme të shoqërisë, mund t'i ndajë aksionerëve të holla apo pjesë në natyrë, pjesërisht apo tërësisht, asetet e shoqërisë (edhe nëse ato janë asete të së njëjtës natyrë), dhe për të njëjtat arsye, mund të caktojë ato vlera që ajo e gjykon të arsyeshme për çdo pasuri që do të ndahet si më lart dhe mund të përcaktojë se si do të kryhet kjo ndarje si midis aksionerëve ashtu edhe midis kategorive të ndryshme të aksionerëve. Mbi bazën e të njëjtit vendim, likuidatori mund t'ia besojë pjesërisht apo tëtalisht këto pasuri të besuarve, por asnjë prej aksionerëve nuk do të jetë i detyruar të pranojë aksionet apo garancitë e tjera që lidhet me ndonjë detyrim.

DËMSPËRBLIMI

138. Gjatë gjithë kohës së ekzistencës së shoqërisë, çdo drejtor do të ketë të drejtë të dëmshpërblehet nga pasuritë e shoqërisë për çdo humbje apo përgjegjësi e cila është e lidhur me ekzekutimin e detyrave të tij duke përfshirë përgjegjësinë e tij në mbrojtjen

përpara cdi procedimi civil apo penal në të cilin është marrë një vendim në favor apo me çfarë parashikohet në nenin 383 të Ligjit, i cili është shkarkuar nga përgjegjësia me vendim gjykata dhe askush prej këtyre drejtorëve nuk do të jetë përgjegjës për ndonjë humbje apo dëmtim që i ka ndodhur shoqërisë gjatë ekzekutimit të detyrave të drejtorëve, detyra që lidhen me funksionet e tyre. Por kjo dispozitë do të ketë efekt vetëm nëse nuk shmangen dispozitat e nenit 197 të Ligjit.

ARBITRIMI

139.

- (a) Në rast barazie votash gjatë votimeve në Asamblenë e Përgjithshme apo në Asamblenë e Bordit Drejtues, vendimi për të cilin pati barazi votash do t'i kalohet për shqyrtim dhe vendim këshilltarit ligjor të Shoqërisë, vendimi i të cilit do të jetë përfundimtar sikur të ishte marrë vendimi me shumicë votash në Asamblenë e Përgjithshme apo në Asamblenë e Bordit drejtues, sipas rastit. Nëse Shoqëria nuk ka caktuar ndonjë këshilltar ligjor dhe as Asambleja e Përgjithshme as Asambleja e Bordit Drejtues nuk bien dakort për këtë emërim, vendimi do t'i kalohet për shqyrtim dhe vendim një këshilltari ligjor që do të zgjidhet nga auditorët e shoqërisë.
- (b) Adresimi i çështjes për arbitrim do të realizohet menjëherë pas barazisë së votave (nëse nuk vendoset ndryshe me shumicë votash menjëherë pas përcaktimit të barazisë së votave) do të zbatohen rregullat e parashikuara në Ligjin Kap 4 (siç mund të ndryshohet herë pas here).
- (c) Në rast se këshilltari ligjor i Shoqërisë është një aksioner i një ortakërie apo i përket ndonjë grupi me disa persona fizikë, arbitri do të jetë një individ i kësaj ortakërie apo grupi personash (siç mund të jetë rasti) dhe do të caktohet me vendim të shumicës së aksionerëve të kësaj aksionerërie apo aksionerësh grupi dhe arbitri nuk do të përjashtohet nga pjesëmarrja dhe votimi për marrjen e këtij vendimi.

EMRAT, ADRESAT DHE PËRSHKRIMI I NËNSHKRUESVE

ABACUS (CYPRUS) LIMITED

Shoqëri me aksione me përgjegjësi të kufizuar

1st floor

Julia House

3 Themistocles Dervis Street

Nicosia – Cyprus

Numri i regjistrimit: 14003

Konfirmoj se kam hartuar Aktin e Themelimit dhe Statutin e shoqërisë

Nënshkruar

Leadbase Limited

Në bazë të vendimit të marrë nga shoqëria e mësipërme më datë 13 Shtator 2001, në përputhje me paragrafin 80 të statutit të shoqërisë, u mor vendimi vijues i posaçëm:

Vendim i Posaçëm

“Emri i shoqërisë në vend të “Leadbase Limited” do të jetë “Dalewest Limited”.

Kopje e vërtetuar me origjinalin

Dora Kaskani
Për Coly Secretarial Limited
Sekretare